

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

16 shtator 2009  
Prishtinë  
API.-KZI Nr. 4/2009

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit ndërkombëtar Emilio Gatti si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarët ndërkombëtarë Norbert Koster dhe Guy Van Craen dhe Gjyqtarët kosovarë Miftar Jasiqi dhe Feizullah Hasani si anëtarë të kolegjit,

në procedurën penale kundër:

**Burim RAMADANIT**, emri i babait Fadil, emri i nënës Vase, i lindur më 20 gusht 1980 në Baicë, Shqiptar kosovar, me vendbanim në Baicë; roje sigurimi në Prishtinë: i pamartuar pa fëmijë; di shkrim lexim: me gjendje të mesme ekonomike, i dënuar me një muaj burgim në fillim të vitit 2002; vazhdimisht i mbajtur në paraburgim nga data 6 korrik 2002; aktualisht në paraburgim në Qendrën e paraburgimit në Dubravë.

**Arsim RAMADANIT**, emri i babait Fadil, emri i nënës Vase, i lindur më 10 tetor 1981 in Baicë, Shqiptar kosovar, me vendbanim në Baicë; roje sigurimi; i shkolluar; vazhdimisht i mbajtur në paraburgim nga data 31 dhjetor 2001; aktualisht në paraburgim në Qendrën e paraburgimit në Dubravë.

**Arben KIQINËS**, emri i babait Miftar, emri i nënës Mihrije, i lindur më 9 gusht 1977 in Baicë, Shqiptar kosovar, me vendbanim në Drenas; ushtar në TMK; i martuar ka një fëmijë; di shkrim lexim: me gjendje të dobët ekonomike; nuk ka dënime të mëhershme; vazhdimisht i mbajtur në paraburgim nga data 6 korrik 2002; aktualisht në paraburgim në Qendrën e paraburgimit në Dubravë.

**Blerim KIQINËS**, emri i babait Xhafer, emri i nënës Zahide, i lindur më 14 janar 1983 në Glllogoc, Shqiptar kosovar, me vendbanim në Baicë; student; i pamartuar nuk ka fëmijë; di shkrim lexim; ka të përfunduar shkollën e mesme; me gjendje të dobët ekonomike; nuk ka dënime të mëhershme; vazhdimisht i mbajtur në paraburgim nga data 4 korrik 2002; aktualisht në paraburgim në Qendrën e paraburgimit në Gjilan.

Duke vendosë mbi ankesat ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 të datës më 20 maj 2008 e cila, me ndryshimin e pjesëshëm të Aktgjykimit të shkallës së parë së Gjykatës së Qarkut në Gjilan të lëndës P. Nr. 162/2003 të datës 7 prill 2005, dënoi katër të pandehurit për kryerjen e veprave penale të pesë **Vrasjeve të rënda** dhe një **Vrasje të rëndë në tentativë** në kundërshtim të nenit 30 paragrafi 1 dhe 2

(pika 1) dhe 3 e Ligjit Penal të Kosovës (LPK) lidhur me nenet 19 dhe 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPRSFJ), të zbatueshme përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 (vepra të dënueshme edhe me nenet 146, 147 pikat 3 dhe 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së), ankesa që ishin paraqitur nga avokatët mbrojtës në emër të Burim RAMADANIT më 28 gusht 2008, në emër të Arsim RAMADANIT më 28 gusht 2008, në emër të Arben KIQINËS më 28 gusht 2008 dhe në emër të Blerim KIQINËS më 2 shtator 2008.

Pasi janë dëgjuar parashtresat e avokatëve mbrojtës Z. Haxhi MILLAKU, Znj. Vahide BRAHA dhe Z. Ibrahim Z. Dobruna, parashtresat e Z. Burim RAMADANI, Z. Arsim RAMADANI, Z. Arben KIQINA dhe Z. Blerim KIQINA dhe mendimi e propozimi i Prokurores së ZPSK-së Znj. Anette MILK në seancën e mbajtur më 15 shtator 2009 dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 15 dhe më 16 shtator 2009.

Duke vepruar sipas nenit 391 të Ligjit mbi Procedurën Penale të RSFJ-së (LPP) sjell këtë

### **AKTGJYKIM**

Ankesat e **Burim Ramadanit** të paraqitura nga Avokatët mbrojtës Haxhi Millaku dhe Vahide Braha **REFUZOHEN** si të pabazuara.

Ankesat e **Arben Kiqina** të paraqitura nga Avokatët mbrojtës Haxhi Millaku dhe Ibrahim Z. Dobruna **REFUZOHEN** si të pabazuara

Ankesa e **Arsim Ramadanit** e paraqitur nga Avokati mbrojtës Haxhi Millaku **REFUZOHET** si e pabazuar.

Ankesa e **Blerim Kiqina** e paraqitur nga Avokati mbrojtës Avni Jashari **HIDHET POSHTË** si e papranueshme.

Sipas nenit 50 të LP SFRJ-së, koha e kaluar në paraburgim për secilin të pandehur është e përfshirë në shumën e dënimit.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 **VËRTETOHET** plotësisht.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë do ti ngarkohen ankuesve.

Me një aktvendim të veçantë është vendosur mbi paraburgimin për secilin të pandehur, sipas neneve 353 dhe 387 të LPP-së.

## ARSYETIMI

### Historia e procedurës

1. Në pranverën vitit 1998 Hamëz Hajra, Polic i punësuar nga qeveria serbe, ishte synim i vrasjes në tentativë të kryer në udhëkryqin e rrugës Tërstenik 2 dhe Glllogoc-Skenderaj, ku ai kishte bërë marrëveshje për tu takuar me Kimete Krasniqin.

Kur Hamëz Hajra iu afrua Kimete Krasniqit ai u sulmua nga disa njerëz të veshur në uniforma të UÇK-së që dolën nga shkurret dhe qëlluan në veturën e tij.

Hajra arriti të vazhdojë të voziste drejt Glllogocit dhe i iku pusisë.

2. Në mbrëmjen e datës 20 gusht 2001 Hamëz Hajra, gruaja e tij Miradija, i biri i tij Xhevdeti dhe vajzat e tij Mimoza, Adelina dhe Pranvera shkuan në dasmë në shtëpinë e Sefedin dhe Rabishe Kiqinës për të festuar martesën e djemve të tyre Bashkim dhe Enver Kiqinës.

Dasma u bë në fshatin Baicë, Rabishe Kiqina ishte motra e Hamëz Hajrës.

Familja e Hajrës mbërriti në dasmë rreth orës 6 pasdite dhe u larguan rreth orës 11 të mbrëmjes, duke udhëtuar me një veturë të kuqe përgjatë rrugës që njihet me emrin rruga e urës së mëhallës së Lanit në mes fshatrave Baicë dhe Tërstenik.

Kur u afruan te ura e drurit vetura u qëllua me të shtëna dhe vetëm Pranvera Hajra i shpëtoi pusisë.

3. Kundër Kimete Krasniqit, prokurori publik paraqiti një aktakuzë më 3 korrik 2002 (nr. 305/2002 ) për vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës të kryer në prill/maj 1998 dhe posedim të paligjshëm të armëve në vitin 2002.

Kundër Skënder Halilajt prokurori publik paraqiti aktakuzë të drejtpërdrejtë më 11 shtator 2002 (nr. 669/2002) për vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës të kryer në prill/maj 1998.

Kundër Skënder Halilajt, **Burim Ramadanit, Arben Kiqinës, Arsim Ramadanit, Zeqir Kiqinës, Florim Kiqinës dhe Blerim Kiqinës** prokurori publik paraqiti një aktakuzë më 7 shkurt 2003 (nr. 523/2002) për bashkëpunim dhe ndihmë dhe nxitje të njëri tjetrit në a) vrasje Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës, b) vrasje në tentativë të Pranvera Hajrës, c) pjesëmarrje në grup që kryen vrasje dhe d) marrëveshje për të kryer veprë penale të ndodhur më 20 gusht 2001.

Kundër Agim Xhilanit, Bekim Morinës, Adem Kiqinës dhe Muharrem Xhemajlit prokurori publik paraqiti një aktakuzë më 5 shkurt 2003 (nr. 415/2002) duke i akuzuar të tre të parët për bashkëpunim në a) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjeve të familjes Hajra, b) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjeve në tentativë të Pranvera Hajrës, c) mos lajmërim të kryerjes së një veprë penale, d) mos lajmërim të veprës penale apo të kryerësit, e) ndihmë të kryerësit pas kryerjes së veprës penale, dhe të katërtin për f) ndihmë të kryerësit pas kryerjes së veprës penale.

4. Më 16 shtator 2003 kolegjii vendosi të konsolidojë aktakuzat e ndryshme dhe të bashkojë procedurat kundër Skënder Halilajt dhe Kimete Krasniqit për vrasje në tentativë të kryer më 1998 me procedurat lidhur me vrasjet dhe vrasjet në tentativë tjera të kryera më 2001.

Vendi i gjykimit u ndryshua prej Prishtinës në Gjilan me vendim të PSSP-së më 7 tetor 2003.

Shqyrtimi gjyqësor filloi më 4 nëntor 2003 dhe zgjati deri më 7 prill 2005

Pas 107 shqyrtimeve aktgjykimi u shpall më 7 prill 2005.

Të pandehurit ishin shpallë fajtorë për këto vepra penale:

- Skënder Halilaj (aktakuza PP. Nr. 669/2002 e datës 11 shtator 2002),

i. Vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës në mes datës 17 prill dhe 30 maj 2008, duke vepruar në bashkëpunim me Kimete Krasniqin dhe të tjerët.

- Skënder Halilaj, **Burim Ramadani**, **Arben Kiqina**, **Arsim Ramadani**, Zeqir Kiqina, Florim Kiqina dhe **Blerim Kiqina** (aktakuza PP. Nr. 523/2002 e datës 7 shkurt 2003),  
ii Vrasje të Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës më 20 gusht 2001 në rrugën mes fshatrave Baicë dhe Tërstenik, të gjithë në bashkëpunim dhe ndihmë dhe nxitje të njëri tjetrit,

iii. Vrasje në tentativë ndaj Pranvera Hajrës më 20 gusht 2001 në rrugën midis fshatrave Baicë dhe Tërstenik, të gjitha në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe nxitur njëri tjetrin,

iv. Pjesëmarrje në grup që kryen vrasje (të anëtarëve të familjes së Hamëz Hajrës), të gjitha në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe nxitur njëri tjetrin

v. Marrëveshje për kryerjen e vrasjes (të anëtarëve të familjes së Hamëz Hajrës), të gjitha në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe nxitur njëri tjetrin,

- Agim Xhilani, Bekim Morina, Adem Kiqina (aktakuza PP. Nr. 415/2002 e datës 5 shkurt 2003),

vi. Mos lajmërimi i përgatitjes së veprës penale të vrasjes së Hamëz Hajrës dhe familjes së tij.

- Muharrem Xhemajli (aktakuza PP. Nr. 415/2002 e datës 5 shkurt 2003),

vii. Ndihmë kryerësit pas kryerjes së veprës penale.

- Kimete Krasniqi (aktakuza PP. Nr. 305/2002 e datës 3 korrik 2002),

viii. Vrasje në tentativë ndaj Hamëz Hajrës mes datës 17 prill dhe 30 maj 2008, e motivuar nga përfitimi personal, hakmarrja e pamëshirshme, motive tjera bazike apo hakmarrja, duke vepruar në bashkëpunim me Skënder Halilajn,

ix. Posedim i paligjshëm i armëve mes janarit 2001 dhe 6 prillit 2002.

Të pandehurit ishin dënuar si në vijim:

Skënder Halilaj dënim total me burgim afatgjatë prej 30 vitesh,

**Burim Ramadani, Arben Kiqina dhe Arsim Ramadani** dënim total me burgim afatgjatë prej 30 vitesh

Zeqir Kiqina dënim total me burgim afatgjatë prej 11 vitesh,

Florim Kiqina dënim total me burgim afatgjatë prej 21 vitesh,

**Blerim Kiqina** dënim total me burgim afatgjatë prej 11 vitesh,

Agim Xhylani, Bekim Morina dhe Adem Kiqina me 4 vite burgim secili,

Muharrem Xhemajli to 4 vite burgim,

Kimete Krasniqi dënim total me burgim prej 6 vitesh.

Të pandehurit Agim Xhylani, Bekim Morina dhe Adem Kiqina ishin liruar nga akuzat e bashkëpunimit në a) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjes së familjes Hajra, b) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjeve në tentativë të Pranvera Hajrës, d) mos lajmërim të kryerjes së veprës penale të vrasjes së Hamëz Hajrës dhe së familjes së tij, apo të kryerësve, e) ndihmë të kryerësit të vrasjes së Hamëz Hajrës dhe familjes së tij pas kryerjes së veprës penale.

5. Të gjithë të pandehurit kanë paraqitur ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.

Pas shqyrtimit të mbajtur më 20 maj 2008 Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e saj AP – KZ 393/2006, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë si në vijim:

i. Ankesat e paraqitura në emër të **Burim Ramadani, Arben Kiqinës, Arsim Ramadani dhe Blerim Kiqinës** u pranuan pjesërisht,

këta katër të pandehur ishin shpallë **fajtorë** për veprat penale të pesë vrasjeve të rënda me qëllim dhe një vrasje e rëndë në tentative me qëllim, në kundërshtim me nenin 30 paragrafët 1 dhe 2 (pika 1) dhe 3 të LPK-së lidhur me nenet 19 dhe 22 të LP të RSFJ-së, të zbatueshme përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 (vepra të dënueshme edhe me nenet 146, 147 pikat 3 dhe 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së), sepse ata së bashku i morën jetën Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës dhe tentuan ti marrin jetën edhe Pranvera Hajrës në mënyrë tinëzare; më 20 gusht 2001 në orën 23:00 në rrugën midis fshatrave Baicë dhe Tërstenik.

**Burim Ramadani, Arben Kiqina dhe Arsim Ramadani** u dënuan me 30 vite burgim, ndërsa **Blerim Kiqina** ishte dënuar me 11<sup>1</sup> vite burgim.

**Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani dhe Blerim Kiqina** ishin liruar nga të gjitha akuzat tjera kundër tyre.

ii. Ankesat e paraqitura në emër të Skënder Halilajt dhe Kimete Krasniqit u pranuan pjesërisht dhe dy të pandehurit u shpallën **fajtorë** për veprën penale vrasje në tentative me qëllim, në kundërshtim me nenin 30 paragrafi 1 i LPK-së lidhur me nenet 19 dhe 22

<sup>1</sup> Dënimi kundër Blerim Kiqinës ishte caktuar të jetë 10 vite burgim por, me një aktvendim të Gjykatës Supreme të datës 18 nëntor 2008 dhe të bërë në përputhje me nenin 358 të LPP-së, kohëzgjatja prej 10 vitesh u konsiderua si gabim material dhe u korrigjua në 11 vite sipas aktgjykimit të shkallës së parë që u konfirmua mbi këtë pikë.

të LP të RSFJ-së, të zbatueshme përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 (vepra të dënueshme edhe me nenet 146 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së), sepse ata së bashku edhe me bashkëpjesëmarrës të paidentifikuar tentuan ti marrin jetën Hamëz Hajrës më 14 apo 15 maj 1998 afër udhëkryqit në mes rrugës për Skenderaj dhe rrugës për Tërstenik 2 .

Kimete Krasniqi për më tepër u shpall **fajtores** për vepër penale posedim ilegal të armëve në kundërshtim me nenin 199 paragrafi 1 i LPK-së dhe nenin 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/17 (vepër e dënueshme edhe me nenin 328 paragrafin 2 të KPPK-së), prej janarit 2001 deri më 6 prill 2002 në Prizren.

Skënder Halilaj u dënua me 5 vite burgim, Kimete Krasniqi me dënim total prej 5 vitesh dhe 6 muajsh burgim.

Skënder Halilaj u lirua nga të gjitha akuzat tjera kundër tij.

iii. Ankesat e paraqitura në emër të Zeqir Kiqinës, Florim Kiqinës, Agim Xhilanit, Bekim Morinës, Adem Kiqinës dhe Muharrem Xhemajlit u pranuan dhe ata janë liruar nga të gjitha akuzat kundër tyre.

6. Blerim Kiqina ishte arrestuar më 4 korrik 2002, Burim Ramadani dhe Arben Kiqina më 6 korrik 2002, Arsim Ramadani më 31 dhjetor 2002, të gjithë mbahen në paraburgim që prej asaj kohe.

7. Avokatët mbrojtës të të pandehurve paraqitën ankesë kundër aktgjykimit siç vijon.

Ankesa e Z. Haxhi Millaku si avokat mbrojtës i të pandehurit Burim RAMADANI ishte paraqitur më 28 gusht 2008.

Ankesa e Znj. Vahide Braha si avokat mbrojtës i të pandehurit Burim RAMADANI ishte paraqitur më 28 gusht 2008.

Ankesa e Z. Ibrahim Z. Dobruna si avokat mbrojtës i të pandehurit Arben KIQINA ishte paraqitur më 28 gusht 2008.

Ankesa e Z. Haxhi Millaku si avokat mbrojtës i të pandehurit Arben KIQINA ishte paraqitur më 28 gusht 2008.

Ankesa e Z. Haxhi Millaku si avokat mbrojtës i të pandehurit Arsim RAMADANI ishte paraqitur më 28 gusht 2008.

Ankesa e Z. Avni Jashari si avokat mbrojtës i të pandehurit Blerim KIQINA ishte paraqitur më 2 shtator 2008.

8. Pas dorëzimit të lëndës te Gjyqtarët e EULEX-it në janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës caktoi seancën ankimore më 15 shtator 2009 ku, pas raportimit të Gjyqtarit raportues, të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës shpjeguan ankesat e tyre dhe Prokurori ndërkombëtar u përgjigj siç është shënuar edhe në procesverbal.

9. Këshillimin Gjykata e bëri më 15 dhe më 16 shtator 2009.

## Gjetjet e Gjykatës

### I

10. Ankesa në dobi të Blerim Kiqinës nga avokati i tij mbrojtës Avni Jashari e datës 2 shtator 2008, sipas nenit 391 LPP ishte paraqitur jashtë rasteve të parapara me ligj sepse:

1. nuk është imponuar ndaj të pandehurit dënimi me vdekje apo dënimi me burgim prej 20 viteve (neni 391.1 nr. 1) por një dënim total prej 11 viteve burgim;
2. gjykata e shkallës së dytë nuk ka mbajtur shqyrtim dhe nuk ka bërë vërtetimin e gjendjes së fakteve ndryshe nga ato të bëra nga gjykata e shkallës së parë (neni 391.1 nr. 2);
3. gjykata e shkallës së dytë nuk ka ndryshuar aktgjykimin lirues (neni 391.1 nr. 3) por konfirmoi aktgjykimin dënues së shkallës së parë.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 20 maj 2008 për Blerim KIQINËN është vendim i formës ë prerë, kundër së cilit mund të propozohet vetëm një mjet juridik jashtëzakonshëm.

Mjeti juridik i propozuar në emër të të pandehurit jo vetëm që ka emrin ankesë por edhe i referohet dispozitës ligjore (nenit 430 Par. 1 pikat 1, 2 dhe 3 të KPPPK-së që është ekuivalent me nenin në fuqi 391 LPP) lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Prandaj, nuk ka dyshim se çfarë mjeti juridik është propozuar dhe se ky mjet juridik nuk lejohet me ligj.

Për këto arsye kjo Gjykatë konsideron **ankesën** e propozuar të paraqitur si të palejueshme me ligj, prandaj duhet të hidhet poshtë në pajtim me nenin 383 të LPP-së.

### II

11. Të gjitha ankesat e paraqitura në dobi të Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit dhe Arben Kiqinës kundërshtojnë aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës në shkallën e dytë për shkak të:

- shkeljeve esenciale të procedurës penale,
- vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- shkeljeve të ligjit penal dhe
- vendimi mbi dënimin.

Me qëllim të shmangies së dyfishimit të është e dobishme të bëhet së pari ekzaminimi i të gjitha aspekteve procedurale të ngritura nga këto ankesa.

Në pjesët pasuese të këtij aktgjykimi do të merren parasysht kërkesat tjera.

12. Faktet e hetuara kanë ndodhë më 20 gusht 2001, kur kodi i procedurës në fuqi në Kosovë ende ishte Ligji mbi Procedurën Penale i RSFJ-së (LPP).

Aktakuzat ishin paraqitur mes korrikut 2002 dhe shkurtit 2003, kurse shqyrtimi gjyqësor filloi më 4 nëntor 2003.

Më 6 prill 2004 Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës hyri në fuqi (KPPPK), neni 550 i së cilit përcakton se “procedurat penale në shkallën e parë ku aktakuza, propozim-akuza apo akuza private është paraqitur para datës së hyrjes në fuqi të këtij kodi por që nuk janë kompletuar deri në këtë datë duhet të vazhdojnë sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm në fuqi deri sa:

- 1) të hidhen poshtë procedurat penale në formë të prerë me aktvendim; apo
- 2) aktgjykimi i lëshuar në shqyrtim gjyqësor të bëhet i formës së prerë”.

Dispozita e nenit 550 të KPPPK-së e bën të qartë se në këtë procedurë, aktgjykimi i së cilës ende nuk është bërë i formës së prerë për ankuesit Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina, se ligji procedural në fuqi është vetëm LPP e jo KPPPK-ja. Dispozitat e tilla të nenit 2.2 të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të kenë lidhshmëri në këtë çështje të ligjit procedural në fuqi (shih ankesën e avokatit Ibrahim Dobruna në emër të Arben Kiqinës faqe 28 versioni anglisht), sepse këto i referohen vetëm ligjit penal e jo atij procedural.

13. Ankesa në emër të Arben Kiqinës tregon se trupi gjykues i Gjykatës shkallës së parë në fillim ishte i përbërë prej një gjyqtari ndërkombëtar Carol Peralta i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte zëvendësuar me një tjetër gjyqtar ndërkombëtar Nurul Islam Khan.

Ankesa pretendon se Nurul Khan nuk ishte gjyqtar rezervë sipas nenit 283 LPP, ai nuk ka asistuar në procedurë gjë që e kishte bërë gjyqtari i mëhershëm Carol Peralta.

Për këtë arsye gjyqtari i ri nuk kishte qenë i informuar rreth procedurave gjersa iu bashkëngjiti trupit gjykues.

Kjo do të mundësonte dy gjyqtarëve tjerë të kenë ndikim në gjyqtarin zëvendësues sa i përket gjyqimit të tij të lirë në këtë rast në dëm të të akuzuarit.

Gjykata e shkallës së dytë do të kishte injoruar këtë shkelje themelore të nenit 364 paragrafi 1 pika 1 LCP.

Kjo çështje do të duhej të ishte hetuar *ex officio* sa i përket përbërjes së duhur së gjykatës së shkallës së parë (neni 376 paragrafi 1 pika 1 dhe neni 364 paragrafi 1 LPP). Kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Siç rezulton prej procesverbalit të shqyrtimit të datës 24 qershor 2004, në këtë rast neni 283 LPP nuk ka gjetur zbatim sepse nuk ishte emëruar asnjë gjyqtar alternativ që do të mund të përcillte procedurën bashkë me ata që ishin të emëruar që nga fillimi.

Para këtij shqyrtimi Gjyqtari Carol Peralta, i cili ishte thirrur në një juridiksion tjetër, ishte zëvendësuar nga Gjyqtari Nurul Khan.

Në atë kohë kolegji zbatoi nenin 305 LPP i cili, në rast zëvendësimi të një gjyqtari tjetër përveç Kryetarit të kolegjit, ofron mundësinë që kolegji ose të rifillojë shqyrtimin gjyqësor prej fillimit ose të vendosë të vazhdojë atë dhe të lexojë proceset e shqyrtimeve të mëparshme. Gjyqtari i ri ka marrë të gjitha procesverbalet e gjyqimit dhe palët pranuan dhe kështu të gjitha shënimet u lexuan.

Prandaj rezulton: se gjyqtari i ri morri pjesë në shqyrtimet prej datës 24 qershor 2004 deri në fund të procedurës, se ai ka marrë dhe ka lexuar të gjitha procesverbalet e mëparshme, se palët kanë pranuar ndryshimin e kolegjit dhe leximin e shënimeve të mëparshme. Nuk ekziston asnjë dëshmi për ndonjë ndikim prej gjyqtarëve tjerë në gjyqtarin Nurul Khan.

14. Ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna në emër të Arben Kiqinës (faqe 11 dhe 20) pretendon se deklaratat e Policit Ndërkombëtar Rodney Hilton të datës 6 dhe 7 gusht 2002 dhe të Pranvera Hajrës të datës 14 tetor 2002 ishin dhënë para Gjyqtarit Hetues (Z. Jean Pierre Lortie) kundër të cilit është paraqitur kërkesa për përjashtim dhe prandaj e tërë puna në këtë lindë duhej të pezullohej menjëherë sipas nenit 43 të LPP-së.

Ekzaminimi i dosjes lejon të kuptohet se gjatë intervistimit të dëshmitarit Policin Ndërkombëtar IPO Rodney Hilton më 6 gusht 2002, avokatët mbrojtës paraqitën një kërkesë për përjashtimin e Gjyqtarit Hetues Z. Jean Pierre Lortie sipas nenit 39 paragrafi 6 i LPP-së (faqe 12) dhe menjëherë pas kësaj braktisën Procedurën Hetimore, që si pasojë ishte ndërprerë.

Gjyqtari Hetues në fund të procesverbalit deklaroi se kërkesa do të dërgohej te Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kompetent për të vendosur mbi këtë çështje, dhe se do të vazhdonte shqyrtimin për dëshminë e Z. Rodney Hilton ditën e ardhshme më 7 gusht, për shkak të urgjencës.

Ajo dëshmi faktikisht është vazhduar më 7 gushtin e ardhshëm.

Më 11 gusht Gjyqtari Hetues informoi avokatët mbrojtës se kërkesa për përjashtim e bazuar në nenin 39(6) të LPP-së është “refuzuar si e papajtueshme me nenet 7 dhe 9 të Rregullores së UNMIK 1999/7”.

I njëjti pohim ishte ngritur më herët dhe ishte vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë (aktvendimet e datës 29 janar 2004 dhe 18 shkurt 2005).

Kjo gjykatë konstaton se kërkesa për përjashtim e bërë sipas nenit 39 paragrafi 6 të LPP-së është një rast unik ku gjyqtari, kundër të cilit është paraqitur kërkesa, nuk është i obliguar të pezullojë tërë punën në atë lëndë menjëherë.

Sipas nenit 43 të LPP-së ai “mund ti marrë vetëm ato veprime për të shmangur shtyrjen deri të arrihet vendimi mbi kërkesën”.

Në këtë rast intervista e Rodney Hiltonit nga Gjyqtari Hetues ishte çështje urgjente, duke marrë parasysh se ky dëshmitar përfundonte misionin më 8 gusht dhe nevojitej ta dëgjonim atë para largimit të tij.

Ky ishte arsyeimi i dhënë nga Gjyqtari Hetues dhe duket se është i drejtë.

Nuk ka asnjë pretendim mbi vendimin për refuzimin e kërkesës për përjashtim.

Aktiviteti hetues i kryer nga ai Gjyqtar Hetues pas hedhjes poshtë të kërkesës së tij (përfshirë edhe dëgjimin e Pranvera Hajrës më 14 tetor 2002) ishte prandaj i rregullt.

Rikujtojmë se Z. Rodney Hilton ishte marrë në pyetje rimarrë në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Nuk ka asnjë pretendim për papranueshmëri lidhur me deklaratat e tij në gjykim.

15. Ankesa e avokates Vahide Braha (faqet 5 – 6) pretendon se Gjykata e Shkallës së Dytë nuk ka aprovuar kërkesën për ndarjen e deklaratës së dhënë nga Blerim Kiqina më

7 korrik 2002 përpara Gjyqtarit Hetues (Z. Vagn Joensen), duke shtuar “i cili është propozuar të përjashtohet”.

Nga ankesa duket se kërkesa për përjashtim ishte propozuar kundër Gjyqtarit Hetues para se ai të merrte këtë deklaratë.

Kjo pikë nuk mund të pranohet.

Intervista e Blerim Kiqinës e datës 7 korrik 2002 ishte intervista e parë e kryer nga Gjyqtari Hetues Z. Vagn Joensen, kurse të pandehurit tjerë ishin intervistuar vetëm në ditët pasuese.

Përbrenda këtij akti dhe në këtë rast në tërësi nuk ka asnjë gjurmë të kërkesës për përjashtim të këtij gjyqtari.

Prandaj, nën këtë paraqitje nuk mund të gjetet asnjë paaftësi e Gjyqtarit Hetues

16. Ankesa e paraqitur nga avokati Haxhi Millaku në emër të Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit dhe Arben Kiqinës pretendon në paligjshmëri të vendimit për udhëheqjen e procedurës së përbashkët për vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës të kryer më 1998 (të pandehurit Skënder Halilaj dhe Kimete Krasniqi) dhe për vrasje të familjes Hajra në gusht 2001.

Ky pretendim, i ngritur edhe në shkallën e dytë, ishte refuzuar nga e njëjta Gjykatë (faqe 11) pasi që vendimi për bashkimin e procedurave nuk përbënte një shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kjo Gjykatë e konsideron pretendimin e ankuesve si të pabazuar duke marrë parasysh se neni 32 i LPP-së mundëson bashkimin e procedurave sa i përket disa personave dhe disa veprave penale nëse ekziston lidhje e ndërsjellë mes veprave penale dhe nëse dëshmitë janë të njëjta (paragrafi 6) apo nëse zhvillohen procedura të ndara pranë gjykatës së njëjtë kundër të njëjtit person për më shumë se një vepër penale (paragrafi 7).

Në këtë rast vendimi për ti bashkuar procedurat ishte i drejtë sipas paragrafit 7 sepse personi i njëjtë (Skënder Halilaj) ishte akuzuar për të dyja veprat e vitit 1998 dhe të vitit 2001.

Kjo jep bazë po ashtu edhe për lidhshmëri të ndërsjellë midis dy fakteve.

Më tutje, paragrafi 8 i nenit 32 të LPP-së nuk lejon asnjë ankesë kundër vendimit për bashkim të procedurave.

17. Çështjet e ngritura mbi **lejueshmërinë** e dëshmive të përdorura prej gjykatave më të ulëta.

Që të dyja aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe të Gjykatës Supreme në shkallën e dytë janë të bazuara në deklaratat e dhëna 1) nga i pandehuri Blerim Kiqina në fazën hetimore, 2) nga dëshmitari i mbrojtur MB dhe 3) nga dëshmitarja Pranvera Hajra. Të gjitha këto burime të dëshmive janë kundërshtuar me ankesa për arsye formale dhe për arsye substanciale.

Pretendimet formale kundër këtyre deklaratave bazohen në çështje të papranueshmërisë, që duhet të shqyrtohet po ashtu *ex officio* sipas nenit 364 paragrafi 1 pika 8 e LPP-së, gjersa ato substanciale, sa i përket besueshmërisë së tyre, mund të shqyrtohen vetëm pasi të jenë vlerësuar këto dëshmi si të lejueshme.

18. Lejueshmëria e deklaratave të dhëna nga **Blerim Kiqina** gjatë fazë hetimore.

Blerim Kiqina ka dhënë deklaratë para policisë më 4 korrik 2002 dhe një deklaratë të dytë para Gjyqtarit Hetues më 7 korrik 2002.

Të gjitha ankesat i definojnë të dyja deklaratat si dëshmi të palejueshme dhe kërkojnë të ndahen nga shkresat e lëndës dhe të mos përdoren për vendim.

19. Deklaratat e dhëna nga Blerim Kiqina para Policisë më 4 korrik 2002.

Gjykata e Shkallës së Dytë (faqet 11 - 13) i refuzoi si të palejueshme deklaratat e dhëna nga Blerim Kiqina në Polici më 4 korrik 2002.

Arsyetimi është i bazuar në shkelje të dispozitës të nenit 151 paragrafi 2 dhe nenit 87 paragrafit 4 të LPP-së, sepse akti i hetimeve, duke përfshirë edhe heqjen dorë nga e drejta për avokat mbrojtës nga i akuzuari, asnjëherë nuk është shënuar me shkrim dhe nuk është nënshkruar nga pjesëmarrësit, Blerim Kiqina dhe policët që intervistuan atë.

Prandaj kjo deklaratë nuk paraqet dëshmi mbi të cilën Gjykata e Shkallës së Dytë apo kjo Gjykatë mund të bazojë arsyetimin e vet.

Kjo do të bënte të panevojshëm çdo diskutim mbi deklaratat e dhëna nga ky i pandehur në Polici më 4 korrik 2002.

Ankesat pretendojnë se, gjatë këtyre deklaratave në Polici, Blerim Kiqinës nuk i janë lexuar të drejtat e tij, të dyshimit të bazuar dhe nuk i është ofruar ndihma e avokatit mbrojtës në rastin e mbrojtjes së obligueshme, video incizimi ishte bërë pa autorizim të Gjyqtarit hetues dhe i pandehuri nuk ishte informuar paraprakisht për këtë lloj të incizimit (ankesa e paraqitur nga avokati Ibrahim Dobruna në faqet 5 – 8, 10 të versionit në gjuhën angleze).

Në pjesën tjetër të ankesave pretendohet se e tërë intervista ishte sajuar nga Policia, Blerim Kiqina ishte shtyrë me forcë dhe mashtruar dhe madje edhe video incizimi ishte në njëfarë mënyre i manipuluar (ankesa e paraqitur nga avokati Haxhi Millaku në faqet 8 – 9, ankesa e paraqitur nga avokati Ibrahim Dobruna në faqe 16, ankesa e paraqitur nga avokatja Vahide Braha në faqet 4 – 6).

Sipas ankesave, shkelja e të drejtave themelore të Blerim Kiqinës dhe presionet e tepruara ndaj tij do të kishin dëmtuar si këtë të pandehur ashtu edhe të pandehurit tjerë dhe do të ndikonte në zhvlerësimin e deklaratave pasuese të dhëna nga vetë Blerim Kiqina para Gjyqtarit Hetues, pasi që përmbajtja e këtyre deklaratave ishte e njëjtë me ato të dhëna tanimë në polici.

Vetëm për këto arsye është i nevojshëm një shqyrtim i shkurtër i shkaqeve të papranueshmërisë të ndryshme nga ato të pranuar nga Gjykata paraprake.

Gjykata e Shkallës së Dytë ishte e interesuar prej ankuesve me pikat e shënuara më lart dhe, pas rishikimit të dëshmimeve të policëve të pranishëm në intervistë dhe në vetë video incizim, përfundoi se para policisë Blerim Kiqinës “i janë dhënë të gjitha të drejtat e mbrojtjes që i lejohen një të akuzuari me anë të mjeteve ligjore vendore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë” (faqe 12) dhe se ai kurrë nuk i është nënshtruar asnjë forme të keqtrajtimit fizik, maltretimit apo kushteve të papërshtatshme gjatë kësaj interviste e as gjatë periudhës kohore para paraqitjes së tij para Gjyqtarit Hetues. Siç është shënuar më lart papranueshmëria e kësaj deklarate lidhej me mungesën e shënimeve të nënshkruara të saj.

Kjo gjykatë e konsideron vlerësimin e bërë nga Gjykata e Shkallës së Dytë si korrekte dhe pa gabime procedurale apo logjike.

- Së pari duhet të shënohet se, sipas ligjit të zbatueshëm në kohën e intervistës, kjo nuk ishte lëndë për mbrojtje të obligueshme.

Mendimi i avokatëve mbrojtës është i bazuar në mendimin gabuar se një krim i ndëshkueshëm me dënimin më të rëndë (burgim deri në dyzet vite) është lëndë për mbrojtje të obligueshme.

Ligji në fuqi në këtë rast është neni 70.1 i LPP-së i cili, në mes tjera rasteve që për këtu nuk janë interesant, mbrojtjen e përshkruan si të obligueshme kur “procedura është duke u zhvilluar për një vepër penale për të cilën mund të shpallet dënimi me **vdekje**”.

Mendimi i mbrojtjes është se, pasi që dënimi me vdekje ishte dënimi më i rëndë, mbrojtja është e obligueshme kurdoherë që ligji imponon dënimin më të rëndë, edhe pse dënimi me vdekje ishte shfuqizuar dhe zëvendësuar me burgim deri në dyzet vite.

Duhet të kujtohet se LPP-ja nuk ka përshkruar mbrojtje të obligueshme për dënim tjetër përveç dënimit me vdekje, edhe pse ishte e mundur të imponohet burgimi me njëzet (neni 38.3 i KPRSFJ) apo më shumë (neni 47 i KPRSFJ) vite.

Dënimi me vdekje ishte shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 Neni 1.5 i cili nuk e kishte zëvendësuar atë.

Rregullorja e ardhshme e UNMIK-ut 2000/59 ndryshoi Rregulloren 1999/24 “sa i përket datës së hyrjes në fuqi së kësaj rregulloreje”.

Neni 1.5 përsërit se dënimi kapital është shfuqizuar, kurse neni 1.6 përcakton:

“Për çdo vepër të ndëshkueshme me dënim me vdekje me ligjin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi do të jetë kohëzgjatja me burgim në mes minimumit të përcaktuar me ligj për atë vepër dhe maksimumit prej dyzet viteve”.

Fjalja e fundit e kësaj Rregulloreje përcakton: “kjo rregullore do të hyjë në fuqi më 27 tetor 2000. Neni i ri 1.6 do të zbatohet vetëm për krimet e kryera pas kësaj date”.

Formulimi fjalëve të këtyre dy Rregulloreve të UNMIK-ut është i qartë në kuptim se dënimi me vdekje thjesht ishte shfuqizuar me Rregulloren 1999/24 dhe nuk ishte zëvendësuar me burgim me maksimum prej dyzet viteve (dënimi më i rëndë i përmendur nga ankuesit) i futur ex novo me Rregulloren 2000/59.

Është e pamundur të zëvendësohet diçka (dënimi me vdekje) që nuk ekziston më, sepse është shfuqizuar me rregulloren paraprake 1999/24.

Kjo del qartë nga teksti i Rregullores 2000/59, sipas së cilës ndryshimet e rregullores 1999/24 zbatohen vetëm “sa i përket datës së hyrjes në fuqi së kësaj rregulloreje”, pra prej datës 27 tetor 2000.

Çka kishte ndodhur ishte se Rregullorja 2000/59 futi një dënim të ri, që zbatohet kurdoherë që ligji në fuqi në Kosovë në mars 1989 përcakton dënim me vdekje, por vetëm për krimet e kryera pas datës 27 tetor 2000.

Nëse dënimi me vdekje të ishte zëvendësuar me burgim deri në dyzet vite kjo do të ishte shkruar qartazi në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24.

Mbi të gjitha, një zëvendësim real do të bënte dënimin e ri të zbatueshëm për të gjitha veprat penale të pranueshme për dënim me vdekje edhe pse të kryera para datës 27 tetor 2000.

Për më shumë ligjvënësi do të kishte specifikuar se zëvendësimi në mes këtyre dy dënimeve do të kishte ndikim në të gjitha institutet e procedurës penale, përfshirë edhe obligimet e mbrojtjes.

Arsyet e lartpërmendura nuk lejojnë ti konsiderojmë të barabarta dënimin me vdekje dhe burgimin deri në me dyzet vite, atë janë dy dënime të ndryshme, të përcaktuara nga ligjvënësi për qëllime të ndryshme dhe me efekte të ndryshme.

Shfuqizimi i dënimit me vdekje ka efekte anësore, si pasojë që të mos e bëjë të zbatueshme për këtë lëndë dispozitën e nenit 70.1 të LPP-së lidhur me mbrojtjen e obligueshme.

Së fundi, siç është konstatuar tanimë nga Gjykata e Shkallës së Dytë, KEDNj-ja nuk parasheh mbrojtjen e obligueshme.

- Së dyti, rishikimi shkresave të lëndës, veçmas i dëshmimeve të policëve që morën pjesë në intervistën e pasdites së 4 korrikut 2002 dhe i video incizimit të saj, ma bind të ndajmë vlerësimin e bërë nga Gjykata e Shkallës së Dytë rreth mungesës së presionit të tepruar, mashtrimit, premtimit të bërë Blerim Kiqinës apo të kushteve të papërshtatshme (përfshirë hapësirën e paktë në dhomë) gjatë intervistës.

Policia ka video-incizuar intervistën me kërkesë të Prokurorit, sipas autoritetit të tij për udhëheqjen e procedurës paraprake penale, të merr hapa veprimi në procedurë, ti delegojë këto te agjencitë e zbatimit të ligjit (nenet 45 paragrafi 2 pikat 1, 49, 153 paragrafi 2, 155 i LPP-së) sepse në atë moment Gjyqtari Hetues ende nuk kishte qenë i përfshirë në këtë pjesë të hetimeve (në fakt kërkesa për hetime kundër Blerim Kiqinës daton 6 korrik 2002).

Prandaj nuk kishte shkelje të dispozitës së nenit 87 paragrafit 1 të LPP-së (shkelje që ashtu kështu nuk ka ndonjë sanksion).

Në fillim të videos Polici njofton Kiqinën të "flasë me zë të lartë që të mund të pranojë mikrofonin", kështu që ai bën të qartë praninë e incizimit.

Sa i përket njoftimit për të drejtat e tij, duhet të rikujtojmë se kur ai u paraqit vullnetarisht në stacionin policor në atë mëngjes Blerim Kiqina ende konsiderohej si dëshmitar dhe vetëm pas pranimit të parë të fakteve pozita e tij u ndryshua në atë të dyshuarit.

Intervista e mëngjesit, kur Kiqina ende ishte dëshmitar, nuk është përdorë kurrë si dëshmi nga Gjykata.

Pas konsultimit me Prokurorin dhe pas shenjës së dhënë nga ky i fundit, policët e intervistuan Blerim Kiqinën pasdite si të dyshuar, jo të arrestuar apo të kapur kundër dëshirës së tij.

Atë vazhdimisht e kanë njoftuar për të drejtat e tij për të pasur ndihmën e avokatit, për të ndalur intervistën në çdo kohë dhe të flasë me avokatin (shih faqet 1 dhe 34 të transkriptimit të video incizimit), e drejtë për të cilën ai ka hequr dorë.

Shpjegimi që ai e dha për refuzimin e ndihmës së avokatit (nuk ka dashur që kjo gjë të përhapet) tregon se kjo heqje dorë është bërë vullnetarisht dhe në mënyrë të informuar.

Në këtë rast akuzat kundër tij ishin përfshirë në deklaratën e tij dhe duhet të rikujtohet se në aktakuzë është raportuar se para deklaratës së Blerim Kiqinës hetimet policore nuk kishin prodhuar dëshmi të mjaftueshme për të arsyetuar akuzat.

Prandaj atë e kishin informuar mirë rreth akuzave.

Deklaratat e tij ishin spontane dhe vullnetare, nga video rezulton se hetuesit ishin në gjendje të formulojnë pyetjet vetëm me për të kompletuar apo qartësuar, por se ata nuk

kishin njohuri të mëparshme rreth përfshirjes së mëhershme personale të të pandehurve dhe rreth detajeve tjera të treguara nga Kiqina.

Ky i fundit u paraqit vullnetarisht një ditë dhe moment që ai ka zgjedhur dhe të ndryshëm nga ai që tregohet nga Policia disa ditë më herët.

Ai as nuk është shtrënguar të paraqitet e as të përgjigjet.

Rishikimi i video incizimit na bind për mungesën e presionit sepse atmosfera e intervistës dhe marrja në pyetje ishin shumë të qeta, zgjatën një kohë të konsiderueshme (dy orë e dy minuta), Blerim Kiqina ishte i lirë vetë, i ulur në pozitë normale, i janë ofruar cigare dhe ujë, asnjëherë nuk është detyruar të përgjigjet asgjë e as nuk është vënë në ndonjë situatë të papërshtatshme.

Mund të përjashtohet çdo manipulim të videos sepse nuk ka asnjë prerje të dukshme apo ndërprerje, pyetjet dhe përgjigjet vazhdojnë dhe lidhen logjikisht me njëra tjetrën.

Koha e intervistës e deklaruar nga zyrtarët (prej 4.08 to 6.10 është dy orë e dy minuta) përputhet me kohëzgjatjen e përgjithshme të videos, po ashtu edhe kjo është një konfirmim i mungesës së prerjeve apo ndërprerjeve në video.

Gjatë video intervistimit nuk ka asnjë sugjerim se policia i ka tregua Blerim Kiqinës çfarë përgjigje të japë.

Për ti përgjigjur pretendimit të ngritur nga ankesa e paraqitur nga avokati Haxhi Millaku (faqet 8 – 9) vërehet se gjatë intervistës Blerim Kiqina pi vetëm dy cigare të parën në mes minutave 41 dhe 55, të dytën në fund të intervistës.

Mungesa e prerjeve apo ndërprerjeve në video konfirmon se është vetëm një cigare në mes minutave 41 dhe 55.

Koha që kjo cigare zgjat mund të shpjegohet me faktin se Blerim Kiqina pi cigaren e parë shumë ngadalë dhe rrallë, pamjet tregojnë se cigarja harxhohet vetvetiu shumë ngadalë.

20. Lidhur me deklaratat e dhëna para Gjyqtari hetues më 7 korrik 2002 ankesat pretendojnë se Blerim Kiqina nuk ka pranuar vërejtjen e parashikuar me ligj dhe se ai nuk kishte pranuar një mbrojtje kompetente dhe efektive.

Kjo pika e fundit është sqaruar duke përkujtuar se nuk dihet se kush e kishte emëruar avokatin mbrojtës i cili ishte i pranishëm, i pandehuri nuk kishte mundësinë që të këshillohej me të, autoritetet nuk kishin konstatuar nëse avokati i emëruar kishte “përvojën dhe zotësinë që i përshtatej natyrës së veprës penale për të cilën ishte akuzuar klienti i tij”, gjatë intervistës avokati nuk i kishte bërë asnjë pyetje klientit të vet, shqyrtimi paraprak i lëndës nuk ishte bërë, baza për dyshimin e ndjekjes penale nuk është diskutuar fare në mes të avokatit dhe të dyshimit, për shkak të mungesës së efikasitetit të mbrojtjes për çka i pandehuri e ka tërhequr avokatin (ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna, faqet 6-8, ankesa e avokates Vahide Braha, faqe 6).

Sipas këtyre ankesave, deklaratat në polici të Blerim Kiqinës po ashtu kanë pasur ndikim në deklaratat e tij para Gjyqtarit hetues, sepse herën e dytë, i pandehuri ka përsëritur “pothuajse fjalë për fjalë” deklaratën e mëhershme, siç është vërejtur edhe nga Gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë ka shqyrtuar këto çështje (faqe 14), duke konstatuar rregullsinë e intervistës dhe lejueshmërinë e këtyre dëshmimeve.

Kjo gjykatë vëren se dy intervistat e dhëna nga Blerim Kiqina para policisë dhe para Gjyqtarit hetues janë formalisht të ndryshme. Prandaj, lejueshmëria e tyre si dëshmi duhet patjetër që të konsiderohet ndaras për secilën prej tyre. Së dyti, i pandehuri është informuar me kohë nga Gjyqtari hetues lidhur me akuzat kundër tij.

Duhet të vërehet se kërkesa për hetime kundër Blerim Kiqinës është paraqitur më 6 korrik, ajo përmban rezultatet e hetimeve të para (të cilat nuk përfshijnë asnjë të pandehur) dhe përmbajtjen e deklaratave të vetë Blerimit para policisë (të cilat në atë moment ishin dëshmi unike për argumentimin e akuzave kundër këtij të fundit dhe kundër të tjerëve).

Gjyqtari hetues ka informuar të akuzuarin për të drejtën e tij për të heshtur dhe Kiqina është përgjigjur se kishte dhënë deklaratë të vërtetë në polici dhe se ishte “i gatshëm të jepte edhe një deklaratë edhe para gjyqtarit hetues”.

Ai ka pranuar avokatin që i është emëruar për ta përfaqësuar dhe ka deklaruar se kishte pasur një takim me të para shqyrtimit. Nga këto elemente mund të përjashtohet çfarëdo shkelje e së drejtave në informimin e të akuzuarit, në përputhje me nenin 218 të LPK-së: në të vërtetë, ai ishte njoftuar për akuzat, të cilat i dinte shumë mirë sepse ato dalin nga deklaratat e tij të mëhershme dhe kishte vendosur që t’i përgjigjes këtyre pyetjeve.

Ai ishte ndihmuar dhe përfaqësuar nga një avokat, të cilin shprehimisht e kishte pranuar për të vetin dhe kishte pasur një takim – bisedë me të para intervistës. Kjo gjë përjashton çfarëdo shkelje të së drejtës për këshillim paraprak me avokatin mbrojtës dhe për rishikim të lëndës, duke pasur parasysh se akuzat kundër Blerim Kiqinës ishin të mbështetura vetëm nga deklaratat e tij të mëhershme.

Pretendimet e ankesave rreth mos-efikasitetit të mbrojtjes nuk janë vërtetuar me asnjë dëshmi sepse avokati ka marrë pjesë akte dhe ka bërë pyetje.

Nga komunikimi i të njëjtit avokat me Gjyqtarin hetues, të datës 3 gusht 2002, ne jemi informuar se avokati ka marrë pjesë në të gjitha shqyrtimet lidhur me të pandehurin, e ka vizituar atë në Qendrën e Paraburgimit, ka kërkuar informacione nga të punësuarit lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe e ka informuar familjen.

Ky avokat nuk është revokuar për shkak të mungesës së profesionalizmit, siç pretendon ankesa, mirëpo ka hequr dorë kur babai i Blerim Kiqinës e ka informuar atë se nuk mund ti përballoj shpenzimet e shërbimeve të tij si avokat mbrojtës.

Nuk është demonstruar asnjë abuzim fizik apo psikologjik i të pandehurit lidhur me këtë intervistë, në të cilën nuk ka marrë pjesë asnjë Polic.

Prandaj, kjo Gjykatë pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së shkallës së dytë.

21. Lejueshmëria e deklaratave të dhëna nga dëshmitari mbrojtës **MB**.

Ankesat (shih ankesën e avokatit Haxhi Millaku, faqet 4 – 5, ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna, faqe 9 dhe ankesa e avokates Vahide Braha, faqet 9 - 10) pretendojnë papranueshmërinë e deklaratave të MB-së për arsye se:

- ajo ka bashkëjetuar me të pandehurin Burim Ramadanin, prandaj ka pasur të drejtë të lirohet nga dëshmimi, as nuk është informuar për këtë të drejtë e as nuk është pyetur nga Gjyqtari hetues apo nga Gjykata se a dëshiron të heq dorë nga kjo e drejtë;
- gjatë shqyrtimit të 27 majit 2004, kur ajo është dëgjuar nga Gjykata e shkallës së parë, publiku është përjashtuar në mënyrë të paligjshme pa vendim të Gjykatës (shkelje e neneve 290 dhe 364, paragrafit 1, pikës 4 të LPP-së) dhe kolegji nuk ka lëshuar aktvendim me shkrim lidhur me masat mbrojtëse për këtë dëshmitar;
- gjatë shqyrtimi gjyqësor Burim Ramadanit i është mohuar e drejta që ti bëjë pyetje MB-së, në kundërshtim të nenit 314 të LPP-së

Këto pretendime janë të pabaza dhe deklaratat e MB-së duhet të konsiderohen si të dëshmi të pranueshme.

Siç shihet më lartë, sipas nenit 550 të KPPPK-së, ligji i vetëm i aplikueshëm në këtë lëndë është LPP-ja dhe jo KPPPK-ja.

Neni 227, paragrafi 1, pika 1 e LPP-së, liron nga obligimi për të dëshmuar vetëm “bashkëshortin/en e të akuzuarit” dhe askënd tjetër, kurse neni 160, paragrafi 1, pika 1 e KPPPK-së, gjithashtu e zgjat këtë lirim nga dëshmimi edhe të “partnerit extra-material të të pandehurit”.

MB-ja nuk ka qenë bashkëshorte e Burim Ramadanit, prandaj, sipas LPP-së ajo nuk është liruar nga obligimi për të dëshmuar.

Së dyti, më 28 prill 2004, trupi gjykues ka vendosur sipas neneve 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20, për të aplikuar masa mbrojtëse për dëshmitarin “të njohur mirë nga njëri i pandehur” dhe i cili ka pasur “marrëdhënie intime me atë”.

Duhet vërejtur se në shqyrtimin gjyqësor vetëm MB-së i janë siguruar masat mbrojtëse dhe që ajo ka pasur marrëdhënie me Burim Ramadanin dhe për këtë arsye ka qenë e njohur për atë.

Aktvendimi përmban në mes tjerash vendimin për përjashtimin e publikut nga shqyrtimi ku dëgjohej dëshmitari.

Përfundimisht, gjatë dëshmimit të MB-së, Burim Ramadani ka pasur mundësi që ti bëjë shumë pyetje asaj.

Kryetari i kolegjit vetëm një herë nuk e ka lejuar një pyetje të Burim Ramadanit lidhur me detajet e marrëdhënies së tyre sepse ka qenë e parëndësishme pasi që ekzistimi i kësaj marrëdhënie tanimë ishte vërtetuar.

## 22. Lejueshmëria e deklaratave të dhëna nga dëshmitarja **Pranvera Hajra**.

a) Në fazën e hetimeve.

Ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna (faqe 20) kundërshton pranueshmërinë e deklaratave të dhëna nga Pranvera Hajra para Gjyqtarit hetues më 14 tetor 2002. Arsyet për këtë kërkesë janë paaftësia e Gjyqtarit për të ndërmar veprime gjatë kohës kur kërkesa kundër tij, për përjashtimin e tij ka qenë e hapur, dhe së dyti fakti që përkundër kërkesës së

avokatëve mbrojtës të të pandehurve, këta të fundit nuk janë ftuar që të marrin pjesë në këtë akt, në kundërshtim me nenin 168, paragrafin 4 të LPP-së.

Pika e parë tanimë është ekzaminuar dhe është gjetur si e pabazuar (shih pikën **II.14**).

Sa i përket pikës së dytë duhet të vërehet se nuk ka pasur shkelje të nenit 168, paragrafit 4 të LPP-së.

Në shkresat e lëndës gjenden fletëpranimet e ftesave të dërguara avokatëve Ramiz Krasniqit, Bajram Krasniqit, Ibrahim Dobrunës, Hafir Bytyqit, Florim Vertopit, Haxhi Millakut, Fehmi Shalës, Musa Dragushës, Xhafer Maliqit dhe Aziz Rexhës, që i referohen procedurës hetimore që duhet të zhvillohen në ditën në vijim: 1, 10, 11, 14, 15, 16 dhe 17 tetor 2002.

Kjo është bërë sipas dispozitave të nenit 168, paragrafit 4 të LPP-së.

Prandaj kërkesa për papranueshmëri të deklaratave të dhëna nga Pranvera Hajra para Gjyqtarit hetues më 14 tetor 2002 është e pabazuar.

b) Gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Pranvera Hajra ka dëshmuar në shqyrtimin gjyqësor më 3 dhe 4 dhjetor 2004.

Ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna në emër të Arben Kiqinës (faqet 9 dhe 20) pohon që publiku është përjashtuar në mënyrë të paligjshme nga këto shqyrtime duke bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kjo pikë është e pabazuar për shkak se dëshmia e Znj. Pranvera Hajrës në shqyrtimin gjyqësor është marrë përmes video-konferencës në një seancë të posaçme të mbyllur, sipas nenit 330 paragrafit 1 të LPP-së, ku siç shihet publiku nuk ka mundur të jetë i pranishëm.

Prandaj nuk ka pasur asnjë shkelje të procedurës penale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor avokatët mbrojtës dhe të pandehurit kanë pasur mundësinë që ta marrin në pyetje Pranvera Hajrën.

23. Ankesa e avokatit Ibrahim Dobrunës kërkon që aktet në vijim duhet të përjashtohen si dëshmi të papranueshme:

-Deklaratat e dëshmitarëve Florim, Blerim, Jeton dhe Arben Kiqinës, të dhëna para Policisë dhe Gjykatës pa u informuar paraprakisht lidhur me të drejtat e tyre (neni 227, LPP-së) që të lirohen nga dëshmia për shkak se janë në lidhje familjare me disa nga të pandehurit (faqet 4-5);

- të gjitha deklaratat e dëshmitarëve dhe të dyshuarve para Policisë pa praninë e avokatëve mbrojtës, sepse mbrojtja është e obligueshme (faqe 11);

- raportet e lëshuara nga organet për zbatimin e ligjit, të cilat përmbajnë deklaratat e zhvleftësuarat të lartpërmendura.

Kjo pikë tanimë është ekzaminuar nga Gjykata e shkallës së parë (faqet 114 – 117 versioni në anglisht), e cila i ka klasifikuar deklaratat e Policisë si të pranueshme dhe të papranueshme. Deklaratat të cilat janë konsideruar si të papranueshme nuk janë përdorur nga gjykata e shkallës së parë, kurse deklaratat tjera të Policisë janë përdorur mirëpo jo “në mënyrë vendimtare që të bazojnë gjetjet kundër cilitdo të akuzuar” (faqe 117).

Kjo Gjykatë vëren që neni 364, pika 8 e LPP-së e konsideron si shkelje esenciale të procedurës penale nëse aktgjykimi është i bazuar në dëshmi të papranueshme “përveç

nëse në dritën e dëshmimeve tjera është e qartë se i njëjti aktgjykim do të ishte sjellë edhe pa atë dëshmi”. Kjo do të thotë dëshmitë e papranueshme mirëpo jo vendimtare nuk kanë ndikim në shkeljen esenciale të procedurës penale në aktgjykim.

Nga aktgjykimi i Shkallës së parë kuptohet që deklaratat e policës nuk janë përdorur në mënyrë vendimtare sepse dëshmitë relevante dhe vendimtare kanë qenë të tjera.

Arsyetimi i Shkallës së parë është i saktë dhe pretendimet e ankesës janë të pabaza.

Sidoqoftë, duhet të shtohet se siç është vërejtur saktë nga Gjykata e shkallës së dytë (faqet 14 - 15), e drejta e përcaktuar me nenin 227 të LPP-së ka të bëjë vetëm me dëshmitarët, kurse të akuzuarit gjithmonë e kanë të drejtën që të heshtin, që është më e gjerë se e drejta e përcaktuar me nenin 227 të LPP-së.

Sa herë që një person është marrë në pyetje si i akuzuar qoftë nga Policia apo nga Gjyqtari hetues, neni 227 nuk ka mundur të zbatohet.

Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve Blerim, Jeton, Florim, Arben Kiqina të dhëna në Polici në gusht dhe shtator 2001, dhe gjithashtu të personave tjerë, duhet të kemi parasysh që në atë kohë ata ende nuk kanë qenë të akuzuar, prandaj neni 227 nuk ka mundur të zbatohet.

Në fakt, siç është raportuar në aktakuzë, gjatë kohës së hetimeve policore nuk janë gjetur prova të mjaftueshme për ta mbështetur akuzën dhe vetëm pas pranimit të parë nga Blerim Kiqina në korrik 2002, kanë filluar hetimet formale.

Së dyti, siç shihet më lart ky nuk ka qenë rast i mbrojtjes së obligueshme, prandaj i akuzuari ka mundur në mënyrë të ligjshme të heq dorë nga e drejta për avokat mbrojtës, siç është konstatuar në secilin rast veç e veç nga Gjykata e shkallës së parë në pjesën e lartpërmendur.

Përfundimisht, arsyet e lartpërmendura gjithashtu vlejné edhe për raportet e Policisë, pjesa e cila është bërë me deklaratat e të pandehurve nuk është marrë parasysh si dëshmi vendimtare nga Gjykata e shkallës së parë.

24. Ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna në emër të Arben Kiqinës (faqet 10 - 11) kërkon papranueshmërinë e listës së telefonave të rrjetit mobil sepse është marrë nga ana e Policisë në mënyrë të paligjshme.

Kjo pikë tanimë është adresuar me aktgjykimin e parë (faqet 117 – 118) duke vërejtur se detajet e thirrjeve janë kërkuar më 23 nëntor 2001 nga Drejtoria për çështje të infrastrukturës/komunikimit, janë marrë, pastaj lista e thirrjeve telefonike i është komunikuar avokatëve mbrojtës.

Gjykata e shkallës së dytë e ka shfrytëzuar këtë listë vetëm për të vërtetuar që thirrja telefonike në mes Zeqir Kiqinës dhe Burim Ramadanit kishte ndodhur para të shtënave.

Pasi që, detajet nuk i kanë konfirmuar deklaratat e Blerim Kiqinës, ato janë përdorur për ta liruar Zeqir Kiqinën (faqet 33 - 34).

Nga shkresat e lëndës shihet që urdhrit të Gjykatës të datës 19 korrik 2002, i është përgjigjur me një listë të thirrjeve telefonike të disa telefonave mobil më 15 gusht 2002.

Duhet të çeket që të dy kërkesat ajo e 23 nëntorit 2001 dhe 19 korrikut 2002, duken të jenë të ligjshme sepse Policia (neni 151, paragrafi 2 i LPP-së) duke vepruar para fillimit të hetimeve dhe Gjyqtari hetues (neni 164, paragrafi 1 i LPP-së) kanë pasur fuqi ligjore për ti ndërmarr veprimet e domosdoshme hetimore dhe për ti ekzaminuar dokumentet e specifikuara.

25. Ankesa (faqet 9 - 10) pretendon që shkelja e nenit 364, pikës 7 të LPP-së, pasi që njëra prej aktakuzave finale (të datës 7 shkurt 2003) Blerim Kiqina nuk është përfshirë dhe përkundër kësaj ai nuk është dënuar nga Gjykata.

Kjo pikë tanimë është ekzaminuar nga Gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin e parë më 4 nëntor 2003 (faqet 18 – 20 versioni anglisht).

Emri i Blerim Kiqinës ishte i përfshirë në aktakuzën origjinale, të shkruar në gjuhën angleze, mirëpo gabimisht mungonte në përkthimin e të njëjtin dokument në gjuhën shqipe.

Ky problem është zgjidhur me përgatitjen e menjëhershme dhe dorëzimin e kopjeve të reja të aktakuzës në gjuhën shqipe, këtë herë përfshirë emrin e Blerim Kiqinës.

Prandaj, pretendimi i ankuesit është i pabazë.

26. Për më tepër, sa i përket shkeljeve esenciale të procedurës penale, ankesa pretendon:

- që aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së dytë nuk përmban arsyetimin mbi faktet vendimtare dhe logjikisht është kundërtënës sepse përmes lirimit të Skender Halilajt eliminohet motivi i krimit kurse mbështet dënimin e kryerësve material (ankesa e avokatit Haxhi Millakut faqet 2, 4, 7 – 9, ankesa e avokatit Vahide Braha faqet 11 - 12);

- që aktgjykimi nuk përmban elemente esenciale të veprave penale dhe sa i përket elementeve objektive dhe subjektive dhe vërtetimin e veprimeve inkriminuese të secilit të pandehur (ankesa e avokatit Haxhi Millakut faqe 2), sa i përket kryerësve, e mira që është kërcënuar, pastaj krijimi i lidhjes në mes të veprimeve dhe të mirës së kërcënuar (ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna faqe 4), se kujt i takojnë armët (ankesa e avokates Vahide Brahës faqe 6);

- që aktgjykimi i tejkalon kufijtë e aktakuzës, pasi që në dispozitiv është cituar vetëm kualifikimi ligjor dhe vepra penale (ankesa e avokatit Haxhi Millaku faqe 9).

Kjo Gjykatë i konsideron të pabaza pretendimet e lartpërmendura.

- Pika e parë është e lidhur me shkeljen e procedurës penale dhe me pretendimin për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

Kjo e fundit do të jetë objekt i ekzaminimit në pjesët e ardhshme të këtij aktgjykimi.

Sa i përket aspektit procedural duhet të vërehet që **motivi** i krimit nuk është pjesë e vetë krimit.

Krimi përbëhet nga dy elemente: atij material (kryerja) dhe atij subjektiv (qëllimi apo neglizhenca) kurse sipas ligjit motivi mbetet jashtë krimit.

Siç duket motivi është më i rëndësishmi për ti kuptuar të gjitha faktet, mirëpo nuk është e domosdoshme për të demonstruar përgjegjësinë e të pandehurit. Nën këtë pikë aktgjykimi i kundërshtuar nuk mund të konsiderohet si jologjik apo i pakompletuar.

- Sa i përket pikës së dytë, aktgjykimi i kundërshtuar ekzaminon në mënyrë specifike faktet dhe dëshmitë që lidhen me secilin të pandehur, sjellja dhe qëllimi i tyre, lidhja në mes të veprimeve të tyre dhe dëmi i shkaktuar jetës së viktimës, veprat penale për të cilat ekziston dënimi (për tre ankesat shih faqet 21 - 27).

Mund të shtohet që sjellja e një personi, i cili prej një distance shumë të afërt në mënyrë vullnetare shtie me armë automatike shumë herë në veturë, brenda së cilës janë gjashtë persona dhe me këtë veprim vret pesë persona, duket qartë që është e qëllimshme dhe në mënyrë shkakore lidhet me vdekjen e viktimave.

- Sa i përket pikës së tretë mund të vërehet që dispozitivi është mjaft i qartë sa i përket sjelljes (“sepse ata së bashku i morën jetën e .....dhe tentuan ta marrin jetën e....në mënyrë tinëzore duke iu zënë pritën atyre derisa po udhëtonin me makinën e tyre dhe duke shtënë në drejtim të tyre me më shumë se një armë dhe me shumë plumba të kalibrit 7.36 x 39 mm”), koha dhe rrethanat lokale (“më 20 gusht 2001, në apo rreth orës 23:00, përgjatë rrugës së paasfaltuar në mes të fshatrave Baicë dhe Tërstenik), identifikimi i viktimave.

Përmes përshkrimit të lartpërmendur të fakteve, dispozitivi nuk e tejkalon aktakuzën, ku faktet e njëjta i janë ngarkuar të pandehurit të njëjtë dhe të tjerëve. Në të vërtetë aktgjykimi i kundërshtuar thjeshtë zvogëlon numrin e të pandehurve, sjelljen dhe krimin të cilat janë konsideruar si të dëshmuara, pa shtuar asgjë në akuzat origjinale.

### III

Pretendimet lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

27. Ankesat (shih ankesën avokatit Haxhi Millakut faqet 2 – 3, ankesën e avokatit Ibrahim Dobrunës faqet 23, ankesën e avokates Vahide Brahës faqe 11), pretendojnë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike sepse disa dëshmi materiale të rëndësishme janë zhdukur gjatë fazës së hetimeve dhe rezultatet e tyre kurrë nuk janë bërë të ditura. Ankesat në veçanti i referohen dorëzës së parafinës të marr nga Florim dhe Arben Kiqina më 21 gusht 2001 dhe ekzaminimit të disa provave të mbledhura në vendet e hetuara të cilat është dashur të ekzaminohen në mënyrë që të gjenden gjurmët e gishtërinjve apo mostrat e ADN-së.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor Prokurori (me 2 nëntor 2004) ka sqaruar që kanaqet e pijeve të gjetura në vendin e krimit janë zhdukur, në anën tjetër sidoqoftë ato janë “lënë jashtë nën ndikimin e forcave natyrore” dhe për këtë arsye nuk ka pasur garanci që ndonjë provë do të mund të gjendej në to.

Së dyti, provat e dërguara në Bullgari për testim janë zhdukur gjithashtu.

Kjo Gjykatë është e mendimit që ky fakt nuk e pengon vërtetimin e saktë të gjendjes faktike sepse mungesa e provave është gjithmonë në dobi të të pandehurit.

Në anën tjetër dënimi mund të shpallet vetëm kur provat inkriminuese ekzistojnë pa asnjë dyshim.

28. Gjykata e shkallës së dytë e bazon aktgjykimin e saj në provat faktike në vijim:

- deklaratën e dhënë nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002;
- deklaratën e dhënë nga dëshmitari i mbrojtur MB;

- deklaratën e dhënë nga Pranvera Hajra;
- deklaratat e dhëna nga dëshmitarët tjerë, në mes të cilëve Nazim Leku, lidhur me kalimin e makinave të të pandehurve para shtëpisë së tij në natën e faktit.

Të gjitha ankesat kanë kundërshtuar besueshmërinë e tri burimeve të dëshmimeve.

29. Ankesat kundërshtojnë besueshmërinë e deklaratave të dhëna nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002.

Bazat e pretendimeve janë kryesisht:

- i dyshuari që pranimi ka qenë rezultat i presionit të tepruar dhe trillimit të Policisë;
- fakti që Blerim Kiqina ka mohuar të dy deklaratat e tij të mëparshme atë para Gjyqtarit hetues (me 11 tetor 2002) dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- disa mospërputhje në mes të këtyre deklaratave dhe provave tjera dhe posaçërisht me
- alibinë e të pandehurit.

Sa i përket pretendimeve për **presion të tepruar** dhe keqtrajtimit fizik duhet të kujtojmë atë çfarë është vërejtur më lart (shih pikën II.19) dhe atë çfarë është deklaruar nga Gjykata e shkallës së dytë lidhur me çfarëdo keqtrajtimi apo teknikave të papërshtatshme të marrjes në pyetje të përdorura nga Policia më 4 korrik 2002, siç është bërë e qartë nga shqyrtimi i videokasetës dhe nga deklaratat e Policëve të cilët ishin të pranishëm gjatë intervistimit.

Nuk pretendohet asnjë keqtrajtimit gjatë intervistimit para Gjyqtarit hetues.

Ankesat ngritin dyshime lidhur me aftësitë mendore të Blerim Kiqinës (shih ankesën e avokates Vahide Braha faqet 3 dhe 17, ankesën e avokatit Ibrahim Dobruna faqe 15) mirëpo këto dyshime janë refuzuar bindshëm nga aktgjykimi i mëparshëm (shih aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së dytë faqe 14 dhe aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë faqe 99) sipas vrojtimeve të bëra nga Dr. Anton Shllaku i cili e ka përjashtuar mundësin që Blerim Kiqina do të mund të definohej si psikotik.

Nuk ka asnjë dëshmi të manipulimit nga ana e Policisë: ai është intervistuar në mënyrë korrekte më 4 korrik 2002, dhe kur ka shkuar para gjyqtarit hetues asnjë Polic nuk ka qenë i pranishëm.

30. Ankesat (shih ankesën e avokatit Ibrahim Dobrunës faqe 16, ankesën e avokatit Haxhi Millakut faqe 8 - 10) pretendojnë që tregimi i Blerim Kiqinës ka qenë rezultat i **trillimit** të bërë nga ana e Policisë.

Kjo çështje së bashku me mohimin e bërë nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor janë adresuar nga Gjykata e shkallës së parë (faqet 59 – 68, 118 – 122, 126 - 128) dhe nga Gjykata e shkallës së parë (faqe 15).

Aktgjykimet e mëhershme kanë përjashtuar çdo trillim të bërë nga Policia përmes arsyetimit pa gabime logjike apo ligjore.

Pikat e rëndësishme të këtij arsyetimi në mes tjerash janë:

- prania e vazhdueshme e së paku një Polici Ndërkombëtar me të pandehurin, i cili asnjëherë nuk është lënë i vetëm me Policin e SHPK-së Fadil Sylevcin;

- kujdesi i Policisë ndërkombëtare i cili ka informuar Prokurorin Ndërkombëtar menjëherë pasi Blerim Kiqina ka filluar ta inkriminoj vetën;
- detajet e treguara nga Kiqina lidhur me faktet, detaje të cilat nuk kanë mund të dihen paraprakisht nga Policia;
- përjashtimi i çfarëdo shenje të keqtrajtimit apo presioni të tepruar në video-xhirim;
- mos-besueshmëria e akuzave ndaj Policëve të ngritura nga Blerim Kiqina gjatë mohimit të tij.

Kjo Gjykatë e ndan vlerësimin e bërë në aktgjykimin e parë dhe të dytë sepse në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë të ndonjë trillimi të bërë nga ana e Policisë.

Në arsyetimin e Gjykatës së shkallës së parë mund të shtohet si në vijim.

Në të vërtetë, sipas Blerim Kiqinës ky trillim pretendohet të ketë filluar vetëm në mëngjesin e 4 korrikut 2002, në ditën e intervistës së tij, dhe jo një vit më herët siç pretendohet në ankesën e (avokatit I. Dobruna faqe 16: “gati një vit ai i ka ngulit në kokë tregimet që duhet ti thonë në kohën e duhur dhe në vendin e duhur, sipas trajnimit që ka marrë, posaçërisht kur do të ishte e nevojshme nga Policët”).

Mirëpo gjithashtu versioni i dhënë nga Blerim Kiqina kur ai mohoi pranimin e tij të mëparshëm nuk është bindës.

Ai pohoi se Fadil Sylevici e ka udhëzuar atë për tërë tregimin, por Fadil Sylevici ka deklaruar që nuk ka pasur qasje në shkresat e lëndës dhe që është përfshirë në rast vetëm më 4 korrik 2002.

Alan Dickson ka konfirmuar që para arrestimit të Blerim Kiqinës vetëm Policët ndërkombëtar kanë pasur rolin e hetuesve në këtë rast (shqyrtimi i 25 gushtit 2004 faqe 31).

Kjo e përjashton mundësinë që Fadil Sylevici të ketë pasur njohuri lidhur me rastin dhe që të japë udhëzime për detajet.

Blerim Kiqina deklaroi që vazhdimisht është udhëzuar nga Fadil Sylevici po ashtu edhe në ditët në vijim deri në momentin e intervistës para Gjyqtarit hetues, mirëpo Alan Dickson deklaroi që Blerimi ka qenë me atë shumicën e kohës para se të dërgohej te Gjyqtari hetues, ai ka qëndruar në zyre me Policët ndërkombëtar “sepse ai nuk ndihej rehatshëm në çeli” (faqe 13): kjo përjashton mundësinë që Fadil Sylevici të ketë pasur rast që ti jap atij instruksione.

Blerim Kiqina deklaroi (intervista e datës 11 tetor 2002, faqe 33), se kur është dërguar te Gjyqtari hetues më 7 korrik 2002, Policët ndërkombëtar e kanë lënë atë vetëm në një korridor të vogël, dhe më pastaj ka ardhur Fadil Sylevici dhe ia ka freskuar memorien se çfarë duhet ti thoshte Gjyqtarit.

Kjo pjesë është tejet e pabesueshme sepse Kiqina ka qenë person i arrestuar të cilin askush nuk do ta linte vetëm në një korridor të vogël me rrezikun që ai do të mund të arratisesh.

Para Gjyqtarit hetues më 11 tetor 2002, Blerim Kiqina deklaroi që ka qenë i keqtrajtuar nga Fadil Sylevici i cili e ka kapur për mjekre dhe e ka shtyre anash (faqe 30).

Gjatë shqyrtimit gjyqësor Kiqina ka shtuar që Fadil Sylevici e ka rrahur atë me shufër në shpinë.

I pyetur se pse fakti i shufrës nuk është cekur në procesverbalin e intervistës para gjyqtarit hetues, Kiqina është përgjigjur se me atë rast ai e kishte cekur edhe këtë detaj mirëpo nuk ka njohuri se çfarë është shkruar aty.

Ky sqarim është në kundërshtim me procesverbalin e intervistës së 11 tetorit, ku ky fakt shumë i rëndësishëm nuk është vërejtur dhe i cili është nënshkruar me kohë dhe po ashtu është konfirmuar nga Kiqina.

Për më tepër, plagët në shpinën e Blerim Kiqinës nuk janë vërtetuar nga doktori përkundër faktit që ai ka qenë në spitalin e Qendrës së Paraburgimit në Dubravë për arsye fiziologjike (shqyrtimi i 11 nëntorit 2003, faqe 41).

Vetëm gjatë shqyrtimit kryesor Kiqina ka paraqitur dyshimin që cigaret që i janë ofruar atij më 4 korrik kanë mundur të përmbajnë ndonjë drogë.

Ky pretendim duket të jetë i vonë dhe jo i besueshëm, përveç që është mohuar nga dëshmitarët dhe nga pamjet e videokasetës të cilat nuk tregojnë ndonjë sjellje të “çuditshme” apo jonormale të Kiqinës apo ndonjë shenjë të dhunës apo kërcënimit ndaj tij.

Blerim Kiqinës i kujtohej që i është dhënë mundësia që të shkoj dhe të jetoj jashtë vendit dhe lidhur me këtë ai e ka përmendur se i pëlqen Anglia.

Sidoqoftë, para Gjyqtarit hetues më 11 tetor 2002, Blerim Kiqina ka deklaruar që kishte folur lidhur me këtë çështje me një Polic amerikan dhe një Polic shqiptar, kurse gjatë shqyrtimit kryesor ka mohuar të ketë biseduar me Policin shqiptar.

Më tutje, gjatë shqyrtimit gjyqësor ai ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë lidhje në mes të bisedës për Anglinë dhe vrasjes së hetuar (shqyrtimi i 11 nëntorit 2003, faqe 35).

Asnjë provë nuk e vërteton pretendimin e Kiqinës dhe të ankesave që atij i është propozuar përfitim për bashkëpunimin e tij me Policinë.

Vetë Kiqina përjashton çdo lidhje në mes të çështjes se në cilin Shtet i pëlqente dhe hetimeve në vazhdim.

Gjykata e Shkallës së Parë ka vërejtur në mënyrë korrekte mos-besueshmërinë e Kiqinës kur ka deklaruar që sugjerimet e përgatitura nga Sylevici do të ishin përfshirë vetëm në katër faqe A4, kur transkriptimi i video-xhirimit ka rreth 36 (tridhjetë e gjashtë) faqe në gjuhën angleze.

Këtu mund të shtohen disa detaje të dhëna nga Kiqina, si për shembull bërtima e Pranvera Hajrës në mes të të shtënave, mund të dihen vetëm nga personi i pranishëm në vend dhe nuk mund të sugjerohet nga Policia.

31. Ankesa e avokatit Vahide Braha (faqe 6) pretendon që aktgjykimi i kundërshtuar nuk i ka kushtuar vëmendje deklaratave të dhëna nga Blerim Kiqina gjatë shqyrtimit kryesor, në këtë mënyrë ka shkelur dispozitat sipas të cilave “gjykata duhet ta bazoj aktgjykimin e saj vetëm në fakte dhe prova të prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor” (neni 347, paragrafi 1 i LPP).

Gjykata e shkallës së parë i ka ekzaminuar të dyja, efektet ligjore dhe faktike të mohimit të bërë nga Blerim Kiqina (faqet 124 - 128) së pari duke sqaruar që të gjitha deklaratat e dhëna nga ai janë prezantuar dhe ekzaminuar në shqyrtimin gjyqësor dhe së dyti arsyet pse Gjykata ka besuar në versionin e parë dhe jo në mohim.

Gjykata e shkallës së dytë (faqe 15) ka konfirmuar korrektësinë ligjore të përdorimit të deklaratës së parë të Kiqinës dhe që aktgjykimi ka gjetur bazën ligjore në të.

Kjo Gjykatë nuk ka gjetur ndonjë shkelje të dispozitave të nenit 347.1 të LPP-së në aktgjykimet e mëparshme, sepse deklaratat e dhëna nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002 janë prezantuar në mënyrë korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor përmes mekanizmit të përcaktuar me nenin 317, paragrafit 3 të LPP-së, që do të thotë se i pandehuri është përballur me to, nga Kryetari i kolegjit.

32. Ankesat pretendojnë që aktgjykimi i kundërshtuar nuk jep asnjë sqarim të vendimit që ka besuar në deklaratat e para të Kiqinës më parë se në **mohimin** e tij (ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna, faqe 16).

Së dyti ata kundërshtojnë logjikën e aktgjykimit sepse lejon besueshmërinë vetëm në një pjesë të deklaratës së parë të Kiqinës (ankesa e avokatit Haxhi Millaku, faqe 8, ankesa e avokatit Vahide Braha, faqe 5).

Pika e dytë do të ekzaminohet në paragrafin e ardhshëm.

Sa i përket pikës së parë mund të vërehet që arsyet pse aktgjykimi i Gjykatës së parë dhe të dytë i kanë besuar deklaratës së parë të Blerim Kiqinës dhe jo mohimit të tij është njaft e qartë me leximin e pjesëve të lartpërmendura të aktgjykimit të parë.

“Trupi gjykues ka konstatuar se mohimi i pranimit nga Blerim Kiqina ka qenë një tentim i pa-afatshëm për ti shpëtuar personat e akuzuar të cilët i kishte implikuar” (aktgjykimi i shkallës së parë, faqe 126).

Kjo Gjykatë e konsideron arsyetimin logjikisht korrekt.

Në momentin e deklaratave të para pranë Policisë, Blerim Kiqina si duket nuk ka pasur arsye apo interes për të shantazhuar vetën dhe të pandehurit e tjerë.

Sapo të përjashtojmë çfarëdo dhune, presionin e tepruar dhe trillimin nga ana e Policisë, nuk mbeten arsye tjera përveç dëshirës që të “shpëtoj nga barra e fajësisë” për vdekjen e fëmijëve, siç është cekur nga Alan Dickson.

Është kuptimplotë tregimi i Policist ndërkombëtar William Sieber i dhënë para Gjyqtarit hetues lidhur me fillimin e bashkëpunimit të Blerim Kiqinës.

Pas disa pyetjeve lidhur me ndjenjat e njerëzve në bashkësi dhe të vetë atij lidhur me vdekjen e familjes Hajra, Sieber rikujton:

“Unë besoj se e kam pyetur “nëse e njeh dikë që do ti bënte gjëra të tilla fëmijëve dhe po ti dije emrat e tyre pse do ti mbroje ata?” Ai është përgjigjur se ata do të më vrisnin. Unë mendoj që e kam pyetur “a do të mund të jetoje me vetveten po ti njihje njerëzit që i kanë bërë gjëra të tilla fëmijëve dhe që do të mund të qëndrojnë të lirë? Dhe mendoj që kam thënë : ” po ta dije kush ka qenë i pranishëm gjatë të shtënave; kush ka qenë te ura, ju e keni për detyrë që ti sillni këta njerëz para drejtësisë”. Unë besoj që e kam theksuar këtë pikë: “ju e dini, apo jo” ai nuk ka thënë asgjë dhe unë kam thënë “apo jo” dhe ai ka thënë “po e di”. Unë e kam pyetur se kush ishin ata. Ai tregoi emrat përfshirë edhe vetën”.

Deri në atë moment Blerim Kiqina ishte duke u intervistuar si dëshmitar, ai nuk ishte i akuzuar për asgjë, nuk ishte nën arrest apo ndonjë formë tjetër të detyrimit, nuk ka pasur çka të përfitoj përmes një tregimi të trilluar.

Ai e përfshiu vetën në këtë rast, duke pranuar se kishte qenë i pranishëm dhe që kishte ndihmuar kryerësit.

Ka qenë e lehtë të parashikohet që si rezultat i deklaratës së tij ai do të arrestohej, dhe saktësisht kështu ka ndodhur.

Asnjë sqarim tjetër i ndryshëm nga ato që janë përdorur nga dy aktgjykimet e para nuk duket të jetë i pranueshëm.

Pranimi i tij ka gjetur vërtetim të jashtëm mbi faktet e rëndësishme dhe detaje esenciale, siç do të ekzaminohen në pjesët e ardhshme.

Në anën tjetër mohimi i tij duket të jetë i pabesueshëm sa i përket dhunës dhe trillimit të bërë nga Policia, i mohuar nga dëshmitë tjera (ai ka deklaruar se ka qëndruar në dasmë për një kohë të vazhdueshme qysh para largimit të familjes Hajra deri në kohën pas këtij largimi, mirëpo në këtë pikë ai është kundërshtuar nga dy dëshmitarë që kanë qenë të pranishëm në dasmë, në mes tyre Pranvera Hajra), i motivuar nga interesi që ti shmanget jo vetëm vështirësive ligjore por edhe çdo mundësie të hakmarrjes kundër tij dhe familjes së tij (Gjykata e shkallës së parë e citon një letër të përgatitur nga familjarët e tij dhe “me domethënie për kërkim falje ndaj të akuzuarit”).

33. Gjykata e shkallës së dytë (faqet 18 - 22) i ka definuar deklaratat e Blerim Kiqinës të datës 7 korrik 2002 si “nga brenda bindëse, të qëndrueshme, detajuara dhe ndryshe të besueshme”.

Aktgjykimi i ka krahasuar këto deklarata me dëshmitë tjera, dhe ka gjetur vërtetim në ekzaminimin e balistikës dhe në “faktet fizike të të shtënave dhe dëshminë e viktimës së mbijetuar, Pranvera Hajrës”.

Gjykata e shkallës së dytë gjithashtu gjen disa mospërputhje lidhur me dy rrethanat e fundit (lidhur me praninë e tij në dasmë para të shtënave dhe në kohën kur ai është takuar me kryerësit të ura) të cilat mund ta vënë në dyshim besueshmërinë e tij jo vetëm lidhur me pikat specifike por gjithashtu “të sjellë ndërmend deklaratat e tij”.

Megjithatë, Gjykata ka vërejtur që “e tërë dëshmia e tij nuk mund dhe nuk do të duhej të kundërshtohet thjeshtë vetëm pse në disa pjesë nuk është e besueshme.... Deklarata e një personi mund të jetë e besueshme në shumë aspekte, mirëpo jo në disa fusha specifike”.

Gjykata ka besuar që të gjejë vërtetim të jashtëm (deklaratat e MB, Pranvera Hajrës dhe dëshmitarëve tjerë në mes tyre Nazmi Lekut) e cila në njërin anë do të mund të konfirmonte pjesët e deklaratës së Blerim Kiqinës dhe në anën tjetër ka qenë **individualisht** e lidhur me disa të pandehur të tjerë (faqe 22).

Pas arsytimit Gjykata e shkallës së dytë ka pranuar:

- që Blerim Kiqina ka qenë në vend dhe ka marrë pjesë në vrasje (duke e kombinuar pranimin e tij dhe dëshminë e Pranvera Hajrës);
- që Burim Ramadani ka marrë pjesë në vrasje (duke i kombinuar deklaratat e Blerim Kiqinës dhe MB-së);
- që Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina kanë marrë pjesë në vrasje gjithashtu (duke i kombinuar elementet e lartpërmendura, faktet që të dy të pandehurit kanë qenë gjithmonë së bashku me Burim Ramadani dhe mundësi materiale për të qenë në vend siç rezulton nga dëshmitë e disa dëshmitarëve lidhur me rrugën e shfrytëzuar nga të pandehurit gjatë udhëtimit të tyre për tu kthyer në pjekjen e shtalbave).

Gjykata e shkallës së dytë nuk i ka marrë parasysh pjesët tjera të deklaratës së Blerim Kiqinës dhe si pasojë i ka liruuar të akuzuarit e tjerë sepse nuk ka mundur të gjejë ndonjë vërtetim vendimtar lidhur me këto pika.

Të gjitha ankesat kundërshtojnë zgjedhjen e Gjykatës së shkallës së dytë pranimin e një pjese të deklaratave të Blerim Kiqinës, të cilat në të kundërtën do të duhej të refuzoheshin në tërësi (ankesa e avokatit Haxhi Millakut, faqe 8, cek metodën e “shfrytëzimit të dëshmimeve sipas nevojës”, shih gjithashtu ankesën e avokates Vahide Brahës, faqet 4, 9, 18: “sipas interpretimit të tillë Gjykata e krijon mundësinë që të besohet që ka të vërtetë në gënjeshtëri” dhe “kjo mund të interpretohet vetëm në bazë të dëshmimeve të cilat i pëlqejnë Gjykatës”).

Për më tepër, ata pohojnë që deklaratat e Blerim Kiqinës përmbajnë shumë intervenime apo gënjeshtër, të ndryshme nga dy pikat e gjetura nga Gjykata e shkallës së dytë, e cila në tërësi e shkatërron besueshmërinë e tyre.

Ekzaminimi i mospërputhjeve të pretenduara të këtyre deklaratave dhe të dëshmimeve të cilat në të kundërtën do të mund ti vërtetonin ato do të bëhet në paragrafët në vijim.

Këtu duhet të adresohet çështja lidhur me besueshmërinë e dhënë nga Gjykata e shkallës së dytë vetëm në një pjesë të këtyre deklaratave.

Kjo Gjykatë është e mendimit që arsyetimi i Gjykatës së shkallës së dytë është, në këtë pikë, jo plotësisht i saktë.

Pas arsyetimit të vetë dhe duke filluar nga realizimi i dy mospërputhjeve të individualizuara, Gjykata e shkallës së dytë e ndanë deklaratën e mbetur të Blerim Kiqinës në dy pjesë: njërin e cila është e besueshme sepse është e vërtetuar nga dëshmitë e jashtme dhe atë e cila nuk është e besueshme sepse nuk është vërtetuar.

Përkitazi me këtë Gjykata e shkallës së dytë i shmanget ekzaminimit dhe përfundimisht të vërtetohet apo mohohet besueshmërinë e deklaratave të Blerim Kiqinës në tërësi, mirëpo e kufizon vetën të zgjedh pjesët të cilat i gjen që janë vërtetuar kurse i përjashton pjesët tjera.

Ky arsyetim duket të jetë ekskluzivisht reduktues dhe nuk është i arsyetuar logjikisht dhe ligjërish.

**Logjikisht** mund të vërehet që besueshmëria e deklaratave duhet të vlerësohet duke marrë parasysh arsyet të cilat mund ta shtyjnë personin që të flasë, ekzistimi i ndonjë rreziku për atë në rast se flet me autoritetet, mënyra e bisedës së tij si bindshmëri e brendshme, qëndrueshmëria dhe detajet e ofruara.

Ekzistimi i dëshmimeve të jashtme dhe vërtetuese akordohet edhe më shumë me besueshmërinë e deklaratës, mirëpo të flasim në mënyrë strikte, nuk është e domosdoshme për ekzaminimin e besueshmërisë. Në rast të vlerësimit pozitiv të singleritetit në tërësi, prania e një mospërputhje të vetme, gabimit apo kontradiktës me dëshmi të ndryshme mund ta refuzoj besueshmërinë në ato pika specifike dhe të vetme mirëpo jo në pjesën e mbetur.

Zakonisht çdo deklaratë e dëshmitarit apo të pandehurit paraqet një përbërje të shumë pjesëve të informatave, disa të mbledhura drejtpërdrejtë nga personi i cili flet, disa të tjera që i janë treguar atij nga personat tjerë.

Në përgjithësi, gabimet në perceptimet e disa fakteve dhe informatat e gabuara të pranuar nga personat e tretë lidhur me disa pjesë të dëshmisë nuk e zvogëlojnë besueshmërinë e saj të përgjithshme.

Kjo është e vërtetë posaçërisht kur faktet e vetme të cilat janë objekt i dëshmive mund të ndahen nga njëra tjetra.

Ky arsyetim vlen gjithashtu në rast se disa pjesë specifike të deklaratës refuzohen nga dëshmitë kundërthënëse.

Në këtë rast vlerësimi i Gjykatës duhet të jetë shumë i kujdesshëm dhe i matur, mirëpo thjeshtë nuk mund të vërtetohet që pasaktësia apo edhe gënjeshtria e vetme dhe specifike automatikisht zvogëlon besueshmërinë e përgjithshme të dëshmisë.

Nëse arsyet nën pikën e kundërshtuar mund të detektohen dhe nuk janë të zgjatura në pjesën tjetër të deklaratës, atëherë kjo pjesa e dytë mund të vlerësohet si e besueshme pa asnjë gabim logjik.

**Ligjërish**, Gjykata nuk është e detyruar që ta përjashtoj një dëshmi në tërësi nëse vetëm një pjesë e saj është kundërshtuar apo është gjetur si jo e vërtetë.

Kjo mbështetet në principin e vlerësimit të lirë të dëshmive nga Gjykata.

Sidoqoftë, vlerësimi i lirë nuk është arbitraritet dhe Gjykata duhet të ofroj arsye të qarta për zgjedhjen e saj, cila duhet të qëndroj logjikisht dhe ligjërish.

34. Në këtë rast deklaratat e dhëna nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002, duket të jenë të besueshme në tërësi, përkundër pranisë së dy mospërputhjeve të vërejtura nga Gjykata e shkallës së dytë.

Tanimë është vërejtur më lart (shih pikën III.32) se ai e ka paraqitur vetën spontanisht në Polici, ka qenë i lirë dhe nuk ka qenë nën asnjë formë të detyrimit, nuk ka pasur asgjë të përfitoj.

Deklaratat e tij së pari kanë qenë vet-inkrimuese dhe për shkak të tyre ai është arrestuar dhe më vonë është dënuar.

Ai nuk ka pasur asnjë arsye që të akuzojë të pandehurit e tjerë me akuza të pavërteta; ai nuk ka pasur urrejtje ndaj tyre dhe duke e shkelur "ligjin e heshtjes" ai e ka ditur fare mirë për rrezikun e hakmarrjes kundër tij dhe familjes së tij, posaçërisht duke e pasur parasysh që ata jetojnë në një ambient të vogël ku të gjithë njihen dhe janë në marrëdhënie familjare apo miqësore me njëri tjetrin.

Arsyeja e vetme e cila mbetet në mënyrë që të sqarohet pranimi i tij duket të jetë pendimi për vdekjen e fëmijëve.

Kjo duket të jetë në mospërputhje me qëllimin për shpifjen ndaj të pandehurve tjerë.

Mund të shtohet që duke e përsëritur vlerësimin tanimë të dhënë nga Gjykata e shkallës së dytë, që deklarata e tij ka qenë "bindëse, e qëndrueshme, e detajuar dhe ndryshe e besueshme". Ata kanë gjetur shumë pjesë të jashtme të vërtetimit, të dy Gjykatat e shkallës së parë dhe shkallës së dytë i kanë pranuar (respektivisht, faqet 123, 124 dhe 22 - 24), të cilat konfirmojnë besueshmërinë e tij të përgjithshme dhe pjesëmarrjen e tij në pritë.

Ata gjithashtu kanë gjetur vërtetim të rëndësishëm në dëshmitë e jashtme të lidhura në mënyrë specifike dhe individuale me të pandehurit e tjerë, siç do të ekzaminohen më tutje.

Gjykata e shkallës së dytë ka sqaruar arsyet të cilat qëndrojnë nën dy rrethanat ku tregimi i Blerim Kiqinës është kundërshtuar nga dëshmitë tjera (faqe 21): “mund të thuhet që versioni i Blerim Kiqinës i deklaratave kontradiktore janë tentim i tij për ta vendosur vetën në pozitë më të mirë në mënyrë që ta zvogëlojë, nëse jo ta eliminoj përgjegjësinë e tij penale. Në esencë ai ka pohuar që nuk ka dashur të marrë pjesë në pritë, mirëpo ka qenë i obliguar të veproj në atë mënyrë për shkak të kërcënimit nga Burim Ramadani”. Këto arsye duket të jenë bindëse dhe sqaron këto mospërputhje pa krijuar dyshime në pjesën e mbetur të tregimit sepse nuk janë të lidhura me faktet e vrasjes në përgjithësi, me pranimin që ka qenë i pranishëm në vend apo të përgjegjësisë së të pandehurve tjerë për të shtënat.

Së dyti, mund të vërehet që vlerësimi i besueshmërisë së përgjithshme të pranimit të Blerim Kiqinës, të bërë duke e marrë parasysh njëri anë të aspektit të brendshëm të deklaratës së tij dhe arsyet të cilat e kanë shtyrë të flasë me autoritetet dhe në anën tjetër ekzistimi i dëshmive vërtetuese të jashtme, respekton dispozitat e neneve 223 dhe 323 të LPP-së sipas të cilit pranimi nga i akuzuari nuk e liron Gjykatën nga detyra për të paraqitur dëshmi tjera dhe në anën tjetër dispozitat e nenit 347, paragrafit 2 të LPP-së, sipas të cilit Gjykata ka për detyrë të vlerësoj secilën dëshmi individualisht dhe në lidhje me dëshmitë tjera.

35. Para paraqitjes së vlerësimit përfundimtar lidhur me besueshmërinë e deklaratave të Blerim Kiqinës, është e domosdoshme të ekzaminohen pretendimet lidhur me **mospërputhjet** e ndryshme nga ato që tanimë janë gjetur nga Gjykata e shkallës së dytë. Ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna (faqet 17 – 19, 23 - 24) kundërshton besueshmërinë e deklaratave të Blerim Kiqinës të datës 7 korrik 2002, sepse tregimi i tij i ngjarjes së 20 gushtit 2001, do të refuzohej nga dëshmitë tjera si:

- takimi pasdite në çajtoren Xhevdeti;
- fakti që Burim Ramadani dhe Arben Kiqina kanë qenë të informuar nga Naim Kiqina që Hamëz Hajra që të merrte pjesë në dasmë në Baicë, kjo thuhet të ketë ndodhur në pasditen kur familja Hajra nuk kishte vendosur ende se a do të merrte pjesë në dasmë.
- ardhja e dy Policëve (Agim Xhylanit dhe Bekim Morinës) te ura e drurit pak para të shtënave;
- kohën në mbrëmje që Blerimi dhe Jeton Kiqina e kanë kaluar në Gllogoc me Lindita Morinën dhe Shemsije Bardiqin
- thirrjet telefonike në mes të pandehurve.

Ankesa e njëjtë pretendon më tutje që përfshirja e Skender Halilajt dhe kinse çmimi që e ka ofruar për vrasjen nuk është dëshmuar fare dhe si rrjedhojë ky i pandehur është liruar.

Mund të vërehet që, edhe pse të gjitha këto pika janë të lidhura me tregimin e Blerim Kiqinës, asnjëra prej tyre nuk i referohet momentit të saktë të vrasjes.

Dëshmitë kundërthënëse përkitazi me këto pika mund të konsiderohen në lidhje me besueshmërinë e përgjithshme të Kiqinës, por në vete nuk është në gjendje të mohojë një pjesë të tregimit të tij të momentit të vrasjes, thjeshtë sepse nuk i referohet atij momenti. Pas këtij vlerësimi të parë dhe të përgjithshëm duhet të vërehet që dëshmitë kontradiktore të cekura nga mbrojtja nuk duken të jenë bindëse.

- Takimi në çajtoresh Xhevdeti, mohohet nga personat të cilët janë akuzuar gjatë gjykimit, prandaj ka qenë në interes të tyre që ta mbrojnë vetën dhe të tjerët, apo kanë qenë në marrëdhënie familjare apo miqësore me ata.

Më tutje, shenjat e pranisë së një liste të gjatë të personave mund të përmbaj disa gabime jo vullnetare.

Elementet tjera faktike si mungesa e regjistrimit të prezencës në TMK më 2001 (faqe 129 e aktgjykimit të parë), mungesa e Arben Kiqinës nga puna në ditën e faktit (dëshmitari Sabit Halilaj, faqe 132), afërsia<sup>2</sup> e çajtores Xhevdeti (ku të pandehurit mohojnë të kenë qenë në pasditen e 20 gushtit) dhe restorantit Era (ku ata, përfshirë Florim Kiqinën, kanë pranuar të kenë qenë aty atë pasdite, faqet 133 - 135) nuk i konfirmojnë deklaratat e të pandehurve dhe nuk lejojnë vlerësimin e tregimeve të tyre si dëshmi kundërthënëse me deklaratat e Blerim Kiqinës.

- Blerim Kiqina i referohet se ka dëgjuar që Burim Ramadani dhe Arben Kiqina janë informuar përmes Naim Kiqinës lidhur me pjesëmarrjen e familjes Hajra në dasmë.

Blerim Kiqina nuk ka qenë i pranishëm në momentin kur është marrë ky lajm nga Naim Kiqina.

Prandaj, mund të mos jetë e vërtetë, apo e bazuar në hipotezën e probabilitetit për shkak të marrëdhënieve familjare në mes të Hamëz dhe Rabishe Hajrës (motër e vëlla) pa e zvogëluar besueshmërinë e Blerim Kiqinës për këtë fakt të vetëm.

Prandaj, ngritja e dyshimit nga koha e supozuar e këtij informacioni (herët në pasdite kur viktimat ende nuk kishin vendosur që të shkojnë në dasmë) nuk është vendimtar në besueshmërinë e deklaratave të tij.

Sidoqoftë, duhet të kemi parasysh që Arben Kiqina dhe Burim Ramadani në prezencë të të akuzuarve të tjerë kanë biseduar me Naim Kiqinën lidhur me pjesëmarrjen e familjes Hajra në dasmë.

Kjo bisedë ka ndodhur në mungesë të Blerim Kiqinës gjatë pjekjes së shtalbave, ku Burim Ramadani ka marrë informacionin për vajzat e Hamëz Hajrës.

Prandaj, thelbi i informatës së referuar nga Blerim Kiqina është i vërtetë: Burimi dhe Arbeni ishin informuar nga Naimi.

- Mbrojtja vërteton që në kohën e dhënë nga Blerim Kiqina (në apo rreth orës 22:30) ka qenë e pamundur për Policët e SHPK-së Agim Xhylanin dhe Bekim Morinën të jenë te ura e drurit, sepse ata kanë qenë me punë në një vend të largët dhe me kolegët e tyre.

Kjo mund të jetë e vërtetë, mirëpo duhet të ekzaminohet duke pasur parasysh që Blerim Kiqina ka treguar që nuk është preciz për kohën për të cilën ka folur.

Në të vërtetë ai ka treguar orën 22:30 kohën kur kanë arritur dy Policët dhe kohën në mes 22:50 dhe 23:00 për të shtënat, dhe është e qartë që të shtënat kanë ndodhur në ora 23:17.

Kryesisht ai gabimisht ka "vlerësuar" kohën e të shtënave.

Blerim Kiqina nuk ka pasur orë me vete dhe thotë që për kohën ka mësuar nga të tjerët. Me fjalë tjera arritja në vend e dy Policëve të SHPK-së të cekur nga Kiqina ka mundur të jetë 22:30.

Pasojë është që, bazuar vetëm në kohën e punës së Agim Xhylanit dhe Bekim Morinës nuk është e mundur të demonstronhet mospërputhja e deklaratave të Blerim Kiqinës.

<sup>2</sup> Sipas Arben Kiqinës (shqyrtimi i 13 janarit 2004, faqe 29) të dy objektet janë përballë njëra tjetrës në dy anët e të njëjtës rrugë.

Në anën tjetër, është e vërtetë që Agim Xhylani dhe Bekim Morina kanë pranuar të kenë arritur në vendin e ngjarjes rreth orës 23:20 ose 23:30, para pjesëtarëve tjerë të Policisë dhe që për një kohë të shkurtër nuk e kanë informuar askënd për vrasjen.

Dallimi në mes të deklaratave të Kiqinës dhe atyre të Agim Xhylanit dhe Bekim Morinës është që këta të fundit kanë arritur në vendin e ngjarjes para apo pas të shtënave.

Deklaratat e Agim Xhylanit dhe Bekim Morinës kanë mundur të jenë diktuar nga interesi i mbrojtjes, pasi që ata janë akuzuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Për më tepër, si ka mundur ta dijë Blerim Kiqina, në mes të gjithë policëve të rajonit, që Agim Xhylani dhe Bekim Morina kanë arritur në vendin e ngjarjes?

Ky element gjithashtu nuk duket të jetë kundërthënës me besueshmërinë e Blerim Kiqinës.

- Gjithashtu koha e Blerim dhe Jeton Kiqinës e kaluar në Glllogoc me dy vajzat nuk duket të jetë vendimtare sepse Shemsije Bardiqi jep kohën (në mes 20:00 dhe 21:30 pa qenë e sigurt, dëgjimi i 16 nëntorit 2004, faqe 11) lidhur me takimin me Blerim dhe Jeton Kiqinën që duket të jetë në përputhje me arritjen e të fundit në dasmë para të shtënave.

- Gjykata e shkallës së dytë ka ekzaminuar thirrjet telefonike në mes të pandehurve duke përfunduar në lirimin e Zeqir Kiqinës dhe se koha e thirrjeve të tij në telefonin e Burim Ramadanit nuk është përputhur me atë çfarë ka treguar Blerim Kiqina.

Thirrjet telefonike tjera nuk janë regjistruar.

Sidoqoftë, Blerim Kiqina nuk thotë që personalisht ka pranuar thirrje telefonike, por tregon për thirrjet e bëra nga të tjerët, p.sh. Burim Ramadani dhe Jeton Kiqina.

Pasaktësia në këtë pikë mund të sqarohet me gabimet në perceptimin e faktit, apo përmes informatave të pavërteta të pranuar nga të tjerët pa përfshirë domosdoshmërisht gënjeshtren.

Pika e lidhur me lirimin e Skënder Halilajt do të ekzaminohet në paragrafin e ardhshëm së bashku me pretendimin e njëjtë të ngritur në ankesën e paraqitur nga avokatja Vahide Braha.

36. Ankesa e avokates Vahide Braha (faqet 12, 17, 19 - 22) kundërshton deklaratat e Blerim Kiqinës në pikat në vijim.

- Lirimi i Skënder Halilajt nga Gjykata e shkallës së dytë e ka privuar krimin nga motivi i tij siç është treguar nga Blerim Kiqina.

Për më tepër, pasi që motivi është “faktor i afërt që ndihmon për të vendosur dhe ndërmarr ndonjë veprim” dhe konsiderohet si “element konstituiv i veprës penale” përjashtimi i motivit i përmbajtur në të dyja, aktakuzën dhe aktgjykimin e parë është dashur ta ketë si pasojë gjithashtu lirimin e kryerësve material dhe ankuesve për shkak të principeve të lidhjes në mes të pandehurve dhe arsyeve për lirim.

- Ngjyra e makinës së Skënder Halilajt.

- Sjellja e Florim dhe Jeton Kiqinës lidhur me furnizimin dhe transportimin e armëve.

- Instruksionet e dhëna Jeton Kiqinës nga Burim Ramadani për ta thirrur atë në momentin

- Thirrja telefonike në mes Zeqir Kiqinës dhe Burim Ramadanit.

- Bartja e kryerësve deri në urën e drurit nga Florim Kiqina.

- Sjellja e Zeqir Kiqinës, pritja e kryerësve te auto-larja.

- Koha e pritës.
- Pozita dhe sjellja e kryerësve gjatë pritës.
- Britma e Pranvera Hajrës në atë moment.

Këtu duhet të vërehet që vlerësimet e bëra më lart, përveç dy të fundit, vërejtjet e mbetura nuk janë të lidhura me vetë momentin e vrasjes dhe të gjitha mund të gjejnë sqarimin e ndryshëm nga jo-sinqeriteti i Blerim Kiqinës.

Gjykata e shkallës së dytë ka liruar Skënder Halilajn dhe të pandehurit e tjerë për shkak të mungesës së dëshmive të vërtetuara dhe jo për shkak të ekzistimit të dëshmive të cilat kanë qenë kundërthënëse me deklaratat e Blerim Kiqinës.

Kjo vlen për motivin e krimit, për furnizimin e armëve, për thirrjet telefonike të ndryshme nga ato në mes të Zeqir Kiqinës dhe Burim Ramadanit, për sjelljen e Zeqir Kiqinës.

Mund të shtohet si në vijim.

- Mungesa e motivit të vërtetuar i bënë dispozitat ligjore të lidhura me arsyet e veçanta të vrasjes të pazbatueshme, si në këtë rast neni 30, paragrafi 2, pika 5 e LPK-së, i cili është përjashtuar nga Gjykata e dytë.

Sidoqoftë, në kundërshtim të pretendimit në ankesë, përjashtimi i motivit specifik apo të qëllimit specifik të krimit nuk do të thotë që automatikisht kryerësit material duhet të lirohen.

Siç është vërejtur më lart, motivi mbetet jashtë strukturës së krimit të vrasjes, të bërë vetëm nga elementi material (sjellja) dhe subjektiv (qëllimi).

- Ngjyra e makinës së Skënder Halilajt duket të jetë detaj jo shumë i rëndësishëm.

Megjithatë, në këtë rast nuk duket që deklaratat e Blerim Kiqinës ka qenë gabim.

Gjykata e shkallës së parë (faqe 129) përkujton që vetë Halilaj ka pranuar se ka pasur një Audi ngjyrë kafe në mes të shumë veturave tjera që ka pasur.

- Jeton Kiqina është gjykuar ndaras; nuk ka vlerësim të gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me dëshmitë e lidhura me të.

Sidoqoftë, vetë ankesa pretendon mungesën e dëshmive të cilat mund të konfirmojnë këto dy pika të deklaratave të Blerim Kiqinës, dhe jo ekzistimin e dëshmive kundërthënëse.

- Thirrja telefonike në mes të Zeqir Kiqinës dhe Burim Ramadanit dhe bartja e kryerësve deri te ura, siç duket të jetë bërë nga Florim Kiqina janë ekzaminuar nga Gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të duhur.

Ekzistimi i këtyre mospërputhjeve nuk e zvogëlon besueshmërinë e përgjithshme të Blerim Kiqinës në pikat tjera.

Sidoqoftë, Blerim Kiqina nuk ka deklaruar të ketë qenë i pranishëm gjatë bartjes së kryerësve deri te ura dhe të ketë parë Florim Kiqinën duke vepruar si vozitës i Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit dhe Arben Kiqinës, mirëpo thjesht është referuar në atë çfarë Burimi ka i thënë Arbenit.

- Siç është vërejtur më lart, Blerim Kiqina nuk ka pasur orë dhe i është referuar kohës vetëm përafërsisht si fakte të vetme.

Kjo e sqaron gabimin e qartë për kohën e pritës, të referuar nga Kiqina si në mes të orës 22:50 dhe 23:00 dhe është konstatuar përmes regjistrimit të bazës ushtarake të Norvegjezëve në orën 23:17.

Gjykata e shkallës së parë (faqet 127 - 128) ka adresuar çështjen që ka të bëjë me nëse dhe në çfarë momenti Blerim Kiqina është larguar nga ahengu në mënyrë të duhur, duke demonstruar që ai është larguar nga ahengu disa minuta para familjes Hajra dhe ka arritur me kohë te ura e drurit para të shtënave.

Gjykata e shkallës së dytë konfirmon këtë pikë duke vërejtur se Kiqina iu kishte referuar disa detajeve të pusisë, të cilat do t'i dinte vetëm një person që ka qenë i pranishëm në pusi.

Dyshimet e ngritura nga avokatët mbrojtës lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve të pranishëm në aheng duket të jenë të paqëndrueshme.

- Pozita e kryerësve në pusi dhe fakti që Blerim Kiqina e ka furnizuar njërin prej tyre me municion janë detaje që nuk mohohen me dëshmi kundërtë.

- Britma e Pranvera Hajrës në mes të të shtënave është një detaj i konfirmuar edhe nga Blerim Kiqina edhe nga vetë Pranvera, që i jep besueshmëri të lartë kësaj pjese të narracionit të këtij të parit dhe konfirmon që ai vërtet ka qenë në atë vend gjatë pusisë. Lidhur me këtë pikë, arsyetimi i gjykatës së shkallës së dytë është i saktë dhe duhet që të mbështetet.

37. Ankesa e avokatit Haxhi Millaku (faqe 6) kundërshton deklaratat e Blerim Kiqinës lidhur me pikat që lidhen me 1) numrin e armëve nga të cilat është shkrepur, 2) numrin e gëzhojave të përdorura, 3) faktin që Burim Ramadani gjoja ka shkrepur dy herë dhe 4) faktin që Blerim Kiqina në të vërtetë ka qenë i pranishëm në vendin e krimit.

Këto pika janë të pabaza.

- Sa i përket numrit të armëve nga të cilat është shkrepur atë natë dhe numrit të gëzhojave të gjetura, gjykata e shkallës së dytë (faqet 18-19):

- vërteton përputhjen e rezultateve të ekspertizës balistike sipas së cilës zjarri është hapur së paku nga dy armë me deklaratat e Blerim Kiqinës, i cili ka thënë se zjarri është hapur nga tri armë;

- pranon hipotezën se Blerim Kiqina ndoshta nuk ka qenë në gjendje të shohë nëse Arben Kiqina, i cili ka qenë në anën tjetër të rrugës ka hapur zjarr nga arma e tij;

- pranon mundësinë që disa gëzhoja nuk kanë mundur të gjenden;

Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar duket të jetë i saktë. Përveç kësaj, duhet të merret parasysh se gjykata e shkallës së parë (faqe 166) ka përmendur mënyrën joprofesionale të përdorur nga ana e ekipit të mjekësisë ligjore, i cili ka ekzaminuar vendin e krimit tek një

ditë pas ngjarjes dhe atë në mënyrë shumë të dobët. Prandaj, nuk mund të përjashtohet mundësia që disa nga gëzhojat nuk janë gjendur.

- Sa i përket numrit të të shtënave të Burim Ramadanit, duhet të konstatohet se deklaratat e Blerim Kiqinës nuk mohohen nga gjetjet në vendin e krimit dhe vërtetohen me deklaratat e Pranvera Hajrës për britmën e saj gjatë të shtënave.

- Ankesa pohon se sipas dëshmisë së Pranvera Hajrës, Blerim Kiqina ka qenë ende në dasmë kur motra e saj e vogël i ka treguar se babai kishte vendosur të nisej.

Ankesa konsideron të pamundur faktin që Blerim Kiqina të ishte në vendin e pusisë në të njëjtën kohë. Përveç asaj që tashmë është konstatuar (shih pikën **III.36**) lidhur me praninë e Blerim Kiqinës në vendin e krimit, mund të vërehet që pretendimi i ankuesit hedhet poshtë nëse e lexojmë deklaratën e plotë të Pranvera Hajrës (shqyrtimi i mbajtur më 4 dhjetor 2004, faqja 15), e cila pasi i kishte thënë gjykatës se Blerim Kiqina ishte i pranishëm kur motra e saj i kishte treguar për vendimin e tyre që të nisen, shpjegon që “megjithatë na mori rreth 20 minuta derisa u ngritëm dhe u nisëm”. Kjo për shkakun që babai dhe vëllai i saj nuk ishin së bashku dhe ata po flisnin me disa të afërm të tyre. “Pastaj, pas afërsisht 10 minutash ai u nis dhe pas 15 minutash arritëm.” Në një pikë tjetër të deklaratave të saj (shqyrtimi i datës 3 dhjetor, faqe 13), asaj i kujtohet që Blerim Kiqina u nis nga dasma përpara se të nisej ajo me familje. Mund të konstatohet që Blerim Kiqina ka pasur mjaft kohë që të arrijë në vendin e krimit. Për këtë arsye, mospërputhjet e pohuara në ankesa duket se janë të paqëndrueshme.

38. Një vlerësim përfundimtar i besueshmërisë së deklaratave të dhëna nga Blerim Kiqina para gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002, mund të bëhet vetëm pas krahasimit të dëshmime vërtetuese dhe kundërshtuese (shih paragrafët në vijim).

Dëshmitë kundërshtuese që ka mbetur të shqyrtohen i referohen **alibisë** së të pandehurve. Të gjitha ankesat pohojnë se aktgjykimi i kundërshtuar nuk ka marrë si duhet parasysh alibinë e propozuar të të tre të pandehurve, sipas të cilës, ata së bashku me të gjithë miqtë e tyre me të cilët sapo kishin ngrënë shtalba (misër), dolën nga prona e Miftar Kiqinës në Baicë me pesë vetura (një Mercedes të bardhë, një Opel Cadet të bardhë, një Volkswagen Passat të kuq, një Audi me ngjyrë të kaltër të mbyllur dhe një Audi tjetër me ngjyrë të gjelbër të mbyllur) dhe duke vozitur në kolonë nëpër rrugën e Çikatovës së Re kanë arritur në Drenas në çajtoren Xhevdet, ku kanë ndenjur tërë mbrëmjen.

Koha kur u nisën nga Baica dhe arritën në Drenas (para orës 23:00), fakti që kanë shkuar së bashku, rruga që zgjodhën – e ndryshme nga ajo e vrasjes, fakti që kanë arritur në Drenas së bashku dhe kanë ndenjur së bashku nuk është marrë parasysh nga aktgjykimi i kundërshtuar, i cili prandaj është i gabuar.

Duhet të vërehet se versionet e dhëna nga shumë persona që kanë marrë pjesë në ngrënien e shtalbave dallojnë nga njëri tjetri lidhur me disa pika të rëndësishme që kanë

të bëjnë me udhëtimin nga vendi i shtalbave në Drenas dhe se këto mospërputhje nuk e mbështesin alibinë e propozuar.

Petrit Sheqir Morina (shqyrtimi më 27 korrik, faqe 17) ka deklaruar se ka qenë në veturën e vozitur nga Xhevdet Kiqina (VW Passat i kuq), dhe se vetura e tyre ka qenë e fundit në kolonë. Ilir Demaku (shqyrtimi më 19 tetor 2004, faqe 14), ka deklaruar se ka qenë në veturën e Zeqir Kiqinës (Audi, e zezë ose e kaltër), së bashku me Petrit Ramadan Morinën dhe se i kujtohet pa qenë plotësisht i sigurt se vetura e tyre ishte e fundit pas veturës së Florim Kiqinës. Florim Kiqina (shqyrtimi më 27 janar 2004, faqe 27) ka deklaruar se kishin lënë vendin e shtalbave me veturën e tij (Audi e gjelbër e mbyllur), së bashku me Fetah Hasanin dhe vetura e tyre ishte e fundit në kolonë.

Fetah Hasani (shqyrtimi më 14 shtator 2004, faqe 35) ka deklaruar se ka qenë në veturë me Florim Kiqinën dhe se vetura e tyre ishte e fundit në kolonë. Përkundër kësaj, ata ishin të parët që arritën në çajtoren Xhevdeti, pak kohë para të tjerëve. I pyetur nëse ai dhe Florimi kishin udhëhequr kolonën me rend, herë njëri herë tjetri apo nëse kishin marrë një rrugë tjetër, ai është përgjigjur jo (faqe 50).

Xhevdet Kiqina (shqyrtimi më 3 nëntor 2004, faqe 15), kujton se vetura e parë vozitej nga Zeqir Kiqina, e fundit nga Florim Kiqina, ndërsa vetura e Xhevdetit ishte e parafundit. Enver Gashi (shqyrtimi më 13 tetor 2004, faqe 38), thotë se Burim Ramadani voziste veturën e parë në kolonë.

Kjo gjykatë vëren se deklaratat e sipërpërmendura nuk mbështesin alibinë e të pandehurve sepse nuk është e qartë si ishte e përbërë kolona, cila ishte vetura e parë e cila e fundit dhe mbi të gjitha si kishte mundësi që vetura që pohohet se ishte nisur e para e fundit (Audi e Florim Kiqinës) arriti e para pa parakaluar fare veturat tjera ose pa marrë ndonjë rrugë tjetër.

Të pandehurit pohojnë se kanë qenë së bashku gjatë udhëtimit për në Drenas, duke formuar një kolonë prej pesë veturash. Nga ana tjetër, mund të vërehet se disa dëshmi të marra tashmë parasysh nga dy aktgjykimet e para, mohojnë këtë pikë të alibisë së të pandehurve.

Dëshmitari **Fetah Hasani** ka pranuar se kanë arritur përpara çajtores së Xhevdetit me Florim Kiqinën përpara derisa të tjerët kishin arritur vetëm pak minuta më vonë. Ky dëshmitar (shqyrtimi i datës 14 shtator 2004, faqe 15) është pyetur për kohën kur kolona ishte nisur nga vendi i shtalbave në Baicë dhe u përgjigj se ishte afërsisht ora 11:00 në mbrëmje.

Ai u përball me deklaratat e tij të mëhershme, në të cilat ai kishte përmendur kohë të ndryshme duke filluar nga 22:30 (deklarata në polici më 27 gusht 2001) deri në 23:30 (deklarata në polici më 10 korrik 2002). Atij i është përkujtuar se kishte deklaruar në polici (deklarata e datës 12 korrik 2002) "Deklaroj se kam treguar të gjitha që i di rreth rastit të datës 20 gusht 2001.

Mund të garantoj vetëm për Florim Kiqinën, sepse tërë kohën kam qenë me të, ndërsa për të tjerët nuk mund të garantoj nëse kanë kryer krimin apo jo”. Në këtë përkujtim, Fetah Hasani u përgjigj se është në gjendje të garantojë vetëm për Florim Kiqinën, sepse ishte së bashku me të tërë kohën dhe se “Unë nuk mund të flas për të tjerët sepse kishte gjëra të tjera për të cilat insistonin tek unë por unë nuk isha atje dhe nuk di se çfarë kishte ndodhur. Ishin katër-pesë vetura dhe unë nuk mund t’i përcillja të gjitha se çfarë po bënin” (shqyrtimi më 14 shtator 2004, faqe 16).

Për më tepër, Fetah Hasanit i kujtohet kur ai dhe Florim Kiqina kishin arritur te çajtorja Xhevdeti, ai kishte parë të vëllain Sami Hasani. Ai u përball me deklaratat e tij në polici, të datës 10 korrik 2002, kur kishte thënë: “kur kemi hyrë në çajtores unë pashë vetëm policin e SHPK-së Ademin në uniformë ndërsa pas pesë minutash edhe vëllain tim Samiun dhe një koleg tjetër”: dhe këtë deklaratë e ka konfirmuar (në shqyrtimin më 14 shtator 2004, faqe 17).

Rreth kohës së arritjes së tjerëve, Fetah Hasani ka thënë se ishte një kohë e shkurtër, pak minuta. Ai në vazhdimësi është përballur me deklaratat e tij të mëhershme para policisë më 12 korrik 2002 kur kishte thënë se “Zeqir Kiqina, Ilir Demaku dhe Petrit Morina kanë ardhur menjëherë pas nesh”, përderisa Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina, Enver Gashi dhe Xhevdet Kiqina kanë arritur “5-10 minuta më vonë”. Fetah Hasani është përgjigjur se ata kishin arritur pas tij dhe Florim Kiqinës, pa qenë në gjendje që të jetë i përpiktë për minutat (faqet 18 dhe 37).

Vëllai i tij, dëshmitari **Sami Hasani** (shqyrtimi më 5 tetor 2004, faqet 8, 11, 16, 17, 18, 19) ka deklaruar se ka dalë nga shtëpia në orën 11:00 apo 11:10 të mëngjesit, ka caktuar një takim për kafe me një koleg, ka parkuar veturën dhe ka parë të vëllain Fetahun dhe Florim Kiqinën në një veturë posa ka dalë nga vetura në rrugë.

Sami Hasani ka shkuar të blejë cigare, 4-5 minuta pas parkimit të veturës ai është takuar me kolegun e tij Muleta dhe 3-4 minuta pas këtij takimi, të dytë kishin hyrë në çajtores Xhevdeti. Në çajtores, ai ka parë vëllain e tij Fetahun dhe Florim Kiqinën së bashku me Zeqir Kiqinën dhe Petrit Morinën, të gjithë duke i bashkuar disa tavolina. Kur e pa së pari vëllain e vet dhe Florim Kiqinën, dëshmitari nuk kishte parë Burim Ramadanin por Xhevdet Kiqinën.

Në çajtores, Sami Hasani u ulë së bashku me Muletën, ndërsa në tavolinën tjetër ishte ulur një koleg tjetër – Adem Kiqina. Pak kohë më vonë, ai dhe kolegët e tij pranuan një kërkesë për ndihmë dhe dolën nga çajtorja. Në kohën kur doli jashtë, Sami Hasanit i kujtohet se në çajtores, mes tjerash, ishin të pranishëm Burim dhe Arsim Ramadani.

Derisa ishte i ulur në çajtores, ai së pari pa Burim Ramadanin në një dyqan pranë çajtores, duke blerë disa ushqime. Sami Hasani u përball me 1) deklaratat e tij para policisë më 12 korrik 2002, kur kishte deklaruar: “derisa po bisedonim në tavolinë të ndarë me kolegun tim Hashim Muleta, afërsisht 7-8 minuta kaluan derisa pjesa tjetër e grupit kishte arritur.

Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina, Zeqir Kiqina, Blerim Kiqina, Jeton Kiqina dhe të tjerët dhe 2) kur ai deklaroi: “kur e kam dhënë deklaratën time të parë nuk kisha idenë e kohës, kështu që pas kësaj deklarate mendova rreth kësaj duke përdorur logjikën dhe erdha në konstatimin se Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina, Zeqir Kiqina, Blerim Kiqina, Jeton Kiqina dhe të tjerët kanë ardhur në çajtore rreth 8 minuta pas meje. Nuk jam i sigurt për Zeqir Kiqinën por për emrat tjerë jam i sigurt”.

Lidhur me këtë përballje, Hasani është përgjigjur se nuk i kujtohej që kishte thënë në polici se ata kishin “arritur”, por pas 7-8 minutash që ai po rrinte ulur në çajtore duke biseduar me kolegët e tij, ai i “pa” të tjerët në çajtore. Ai po ashtu u përball me një pjesë tjetër të deklaratave të tij para gjyqtarit hetues kur iu kujtua “nuk e di nga erdhën ata, kur i pashë të dyshuarit e sipërpërmendur duke hyrë në çajtore pas meje”. Ai u përgjigj se kishte vërejtur praninë e të tjerëve në çajtore.

Dëshmitari **Hashim Muleta** (shqyrtimi më 6 tetor 2004), sjell ndër mend që ka arritur në stacionin policor në Drenas në orën 23:00, ka takuar Sami Hasanin dhe ka hyrë së bashku me të në çajtore, derisa në çajtore ai ka parë 5 apo 6 persona duke i bashkuar tavolinat.

Pas disa minutash (3-4 minuta), 4-5 persona të tjerë kanë ardhur në këmbë dhe i janë bashkuar grupit të parë. Deklaratat e Sami Hasanit konfirmojnë ato të të vëllait të tij Fetahut lidhur me atë se Samiu dhe kolegu i tij Muleta kanë hyrë në çajtoren Xhevdeti pak minuta pas Fetahut dhe Florimit (Fetahu thotë se bëhet fjalë për 5 minuta).

Të dy deklaratat përputhen njëra me tjetrën për faktin se të tjerët, duke përfshirë Burim dhe Arsim Ramadani dhe Arben Kiqinën kanë arritur disa minuta më vonë (Samiut i kujtohet 7-8 minuta pas arritjes së tij, Fetahu thotë 5-10 minuta pas arritjes së tij). Hashim Muleta ka konfirmuar se grupi i parë tashmë ishte në çajtore, përderisa grupi i dytë kishte arritur më vonë. Duke pasur parasysh:

- 1) Kohën fillestare të tregimit të Sami Hasanit (në mes orës 23:00 dhe 23:10, kur doli nga shtëpia),
- 2) Kohën derisa ka arritur në qendër të Drenasit, ku ai pa të vëllain e vet Fetahun dhe Florim Kiqinën (ai ka thënë se në përgjithësi duhen në mes 10 deri në 15 minuta, faqe 41),
- 3) Kohën e nevojshme për Sami Hasanin për ta takuar kolegun e tij Muleta, pas parkimit të veturës (4 ose 5 minuta),
- 4) Kohën e nevojshme për ata të dy për të hyrë në çajtore (3 apo 4 minuta) dhe
- 5) Në fund kohën e nevojshme për të pandehurit që të arrijnë në çajtore pas Sami Hasanit (7 apo 8 minuta)

Mund të përfundohet se pohimi i të pandehurve se kanë arritur në Drenas dhe në çajtore së bashku dhe para kohës kur janë shkrepur të shtënat, nuk qëndron si i tillë. Duhet të shtojmë se të pandehurit kanë deklaruar se me ardhjen e tyre në çajtoren e Xhevdetit, Sami Hasani dhe kolegët e tij tashmë gjendeshin aty.

Ata kanë pohuar se edhe Fetahu edhe Sami Hasani po gënjenin, por një gjë të tillë nuk është provuar. Florim Kiqinës i kujtohet se duke u kthyer ai dhe Fetah Hasani ishin në veturën e fundit në kolonë.

Pak para se të niseshin nga vendi i shtalbove, ai është takuar me Bashkim Kiqina i cili e informoi atë lidhur me dasmën dhe e ftoi që të merrte pjesë në të. Florimi iu përgjigj se nuk kishte kohë, piu pak dhe për t'i bërë nder nxori revolen dhe shtiu pesë herë në ajër.

Ky episod, i cili ashiqare i vonoi ata për t'u nisur nga vendi i shtalbove nuk ishte vërejtur nga pjesëmarrësit e tjerë (shih p.sh. Enver Gashin, Petrit Ramadan Morinën, Xhevdet Kiqinën) përkundër supozimit të tyre se kanë qenë së bashku tërë kohën.

Enver Gashi (shqyrtimi më 13 tetor 2004, faqet 24 dhe 31) ka deklaruar se ka qenë në veturë (Mercedes i bardhë), të vozitur nga Burim Ramadani dhe që ia kishte dhënë veturën e vet (Opel Cadet i bardhë) Arsim Ramadani dhe Arben Kiqinës.

Arsimi ka vozitur veturën dhe kishte pirë mbase më shumë sesa 20 birra. Sipas Enver Gashit, nuk ka ekzistuar ndonjë arsye e veçantë pse ai ka qenë në veturë të Burimit, ndërsa të tijën ia kishte dhënë Arsimit.

Ky tregim duket të jetë pak i besueshëm, ngase nuk kishte arsye për Enver Gashi të ishte në një veturë tjetër e jo në të vetën dhe do të ishte e rrezikshme që t'ia lëshonte veturën e vet një personi (Arsimit), i cili kishte pirë aq shumë. Duhet të përkujtohet se Nazmi Leku (shqyrtimi më 23 nëntor 2004, faqet 21, 22) kishte parë Arsim Ramadani duke vozitur Mercedesin e bardhë dhe nuk kishte parë asnjë udhëtar tjetër në atë veturë<sup>3</sup>.

Në fund, duhet të konstatohet se alibia e të pandehurve është e dhënë me deklaratat e vetë të pandehurve ose të personave që janë të lidhur me ta qoftë me lidhje familjare, miqësore ose lidhje ushtarake – përkatësinë e tyre në trupat e njëjta ushtarake. Të gjitha këto hedhin dyshime në sinqeritetin e tyre dhe në vullnetin e tyre për të bashkëpunuar në hetime.

Elementet e përmendura nuk ia mundësojnë kësaj gjykate që të konsiderojë alibinë e të pandehurve si të provuar 1) në lidhje me arritjen e përbashkët të tyre në çajtoren Xhevdeti dhe 2) në lidhje me momentin e tyre të arritjes në çajtores në kohën e cila nuk do të ishte në përputhje me praninë e ankuesve në vendin e krimit kur ndodhi vrasja.

39. Mund të përfundojmë se arsyet e përmendura më sipër, të lidhura me motivet e pranimit të tij, me saktësinë dhe përputhjen e deklaratave të tij (shih pikën **III. 34**), me mungesën e mospërputhjeve të rëndësishme (shih pikat **III. 35-37**) dhe me mospërputhjen e alibisë së ankuesve (shih pikën **III. 38**), konfirmojnë besueshmërinë e deklaratave të dhëna nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002.

Siç është theksuar nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, deklaratat e tij vërtetohen edhe me dëshmitë tjera të cilat konfirmojnë qoftë besueshmërinë e tij të përgjithshme

<sup>3</sup> Lidhur me dëshminë e Nazmi Lekut shih paragrafin nr. 42.

qoftë pikat specifike të narracionit të tij që ka të bëjë me përfshirjen e të tre ankuesve në vrasje.

Duhet të përmendet se, edhe pse me rëndësi, vërtetimi nga jashtë përfaqëson vetëm diçka që edhe logjikisht edhe ligjërisht konfirmon besueshmërinë e Blerim Kiqinës, pasi që besueshmëria e tij tanimë është demonstruar me elementet e përmendura më lart.

Me fjalë të tjera, deklaratat e Blerim Kiqinës – për shkak se janë konstatuar të jenë të besueshme – vetvetiu dëshmojnë përgjegjësinë e tij dhe të Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit dhe Arben Kiqinës për veprat penale me të cilat ngarkohen.

40. Gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar vërtetimin e parë të Blerim Kiqinës në deklaratat e Pranvera Hajrës. Deklaratat e viktimës janë përdorur për ta konfirmuar praninë e Blerim Kiqinës në vendin e krimit sepse të dy palët deklarojnë se gjatë të shtënave është dëgjuar britma e një vajze (Pranvera Hajrës), që ishte një detaj që mund ta dinte vetëm dikush që ka qenë i pranishëm në atë vend.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur edhe pikën e dytë të kontaktit në mes të deklaratave të këtyre dy personave, të cilat i referohen ngadalësimit të veturës së viktimave duke iu afruar urës.

Ankesat kanë kundërshtuar këtë pikë në mënyrë shumë të përgjithësuar (shih ankesën e avokates mbrojtëse Vahide Braha, faqe 9 dhe 21), e cila pretendon se këto dy deklarata nuk ishin të ngjashme.

Kjo gjykatë ndan mendimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse tregimi i Blerim Kiqinës (deklaratat më 7 korrik 2002, faqe 3) dhe i Pranvera Hajrës (deklaratat më 14 tetor 2002, faqe 9 dhe 10) përputhen dhe mbështesin njëra tjetrën në atë pjesën që i referohet britmës së vajzës “gjatë të shtënave” (Hajra, faqe 10), që do të thotë se krismat (të shtënat) kanë vazhduar pas britmës së saj, saktësisht ashtu siç tregohet edhe nga Blerim Kiqina. Ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna (faqe 21) kundërshton deklaratat e Pranvera Hajrës në një pikë tjetër që ka të bëjë me veturën dhe personat që ishin brenda saj, e cila veturë iu afrua veturës së viktimave pak minuta pas sulmit.

Kjo pikë tanimë është pranuar nga gjykata e shkallës së dytë dhe nuk ka arsye që të ndryshohet vlerësimi i saj. Mund të shtojmë se Blerim Kiqina në tregimin e tij tregon jo vetëm për ngadalësimin e veturës së viktimave që vërtetohet në deklaratat e Pranvera Hajrës por edhe për pozitën që e merr vetura pas të shtënave – mu në dalje prej urës, ashtu siç përshkruhet nga Kiqina – dhe të konfirmuar me fotot e vendit të krimit.

Siç është konstatuar me të drejtë nga Gjykata e shkallës së dytë, këto elemente konfirmojnë praninë e Blerim Kiqinës në vendin e krimit dhe pjesëmarrjen e tij në krim.

41. Besueshmëria e deklaratave të dëshmitarit M.B. Dy aktgjykimet e para kanë vlerësuar deklaratat e M.B. si të besueshme.

Gjykata e shkallës së dytë (faqe 24 dhe 25) i ka shfrytëzuar ato si vërtetim të deklaratave të Blerim Kiqinës në mënyrë që ta mbështesë përgjegjësinë e Burim Ramadanit për vrasjen e familjes Hajra. Akesat e kundërshtojnë besueshmërinë e M.B. për shkak të:

-arsyeve për hakmarrje kundër Burim Ramadanit (shih ankesën e avokatit Haxhi Millaku, faqe 5, 9, ankesën e avokatit Ibrahim Dobruna, faqe 27, ankesën e avokatit Vahide Braha, faqe 7, 8, 10, 22, 23);

-faktit se dëshmia e saj ishte jo e drejtpërdrejtë, ajo ka mundur vetëm të supozojë por jo të demonstrojë përmbajtjen e besimit të marrë nga Burim Ramadani (ankesa e avokates Vahide Braha, faqe 23, 24).

Kjo gjykatë nuk pranon pohimet e ankuesve për këto arsye:

-duhet patjetër të konstatohet se M.B. nuk ka qenë – as ligjrisht as praktikisht – dëshmitar “anonim”, edhe pse dy gjykatat e para i referohen në këtë mënyrë.

Në aspektin ligjor, aktvendimi i datës 28 prill 2004 zbaton nenet 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/20, të cilat i referohen Kërkesës (neni 2) dhe Masës mbrojtëse për palët e dëmtuara dhe dëshmitarët (neni 3).

Ky aktvendim nuk zbaton nenin 4 që i referohet Urdhrit për anonimitet. Në mesin e masave mbrojtëse të lejuara me nenin 3, paragrafin 1 është edhe heqja e emrave (pika a) dhe caktimi i pseudonimit (pika d). Ky aktvendim ka vendosur që mos të zbulohet emri i dëshmitarit por të identifikohet vetëm me initiale.

Në këtë mënyrë, referimi për anonimitetin e dëshmitarit në dy aktgjykimet e para nuk është i saktë, për arsye se ajo ka qenë dëshmitare e “mbrojtur” dhe jo “anonime”. Praktikisht, M.B. është person i njohur mirë jo vetëm nga Burim Ramadani, me të cilin ajo kishte pasur marrëdhënie, por edhe nga Arben Kiqina, i cili ka dëshmuar për këtë marrëdhënie.

Këtu mund të shtojmë se neni 4, paragrafi 2, pika d e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/20 përcakton që “nevoja për anonimitetin e dëshmitarit apo palës së dëmtuar me qëllim të zbatimit të drejtësisë, tejkalon interesin e të akuzuarit për të ditur identitetin e dëshmitarëve gjatë përgatitjes së mbrojtjes”. Por në këtë rast, mbrojtja e Burim Ramadanit nuk ka qenë e kufizuar në asnjë mënyrë nga pseudonimi që i është dhënë kësaj dëshmitareje, ngase i pandehuri e ka njohur shumë mirë atë.

-është pohuar në ankesa se Burim Ramadani dhe dëshmitarja M. B. kanë bashkëjetuar. Një gjë e tillë nuk mbështetet me dëshmitë e dhëna nga vetë ankuesit. Arben Kiqina (shqyrtimi më 14 janar 2004, faqe 23) i ka deklaruar Gjyqtarit hetues dhe pastaj edhe në gjykim se kjo vajzë dhe Burim Ramadani kishin pasur një aventurë, ajo kishte qenë me Burimin disa herë.

Kiqina kishte pasur një bar për një periudhë prej një muaj e gjysmë gjatë vitit 2001. Ai ia kishte dhënë çelësat Burimit për ta kaluar natën me këtë vajzë. Nga aktgjykimi i Gjykatës së qarkut të Prishtinës, i datës 20 maj 2002 dhe lidhur me shkurorëzimin e Burim Ramadanit dhe të Remzije Shalës kuptohet se:

-ata ishin martuar më 2 prill 2001;

-janë shkurorëzuar më 20 maj 2002 me pajtim reciprok;

-të dy kanë deklaruar se marrëdhëniet martesore në fillim i kishin të mira, por më vonë ato ishin përkeqësuar në atë masë sa që kishin pamundësuar jetën e tyre të përbashkët. Burim Ramadani (shqyrtimi më 27 maj 2004), faqe 35), ka deklaruar në lidhje me M. B. se ka qenë në marrëdhënie me të që nga fillimi i qershorit 2001 deri në fillim të janarit 2002, kur ishin ndarë.

Nga dëshmitë e përmendura, nuk ka mundësi që të konstatohet se Burim Ramadani dhe M. B. kanë bashkëjetuar gjatë marrëdhënies së tyre, ngase Burimi ishte ende i martuar dhe po jetonte me familjen e vet. Për më tepër, mundësia për t'i kaluar dy net së bashku në një bar apo kudo qoftë, brenda një periudhe të shkurtër kohore nuk mund të përkufizohet si bashkëjetesë.

-Ankesat përmendin që, sipas dëshmitarit Sami Ferizi (shqyrtimi më 24 janar 2005), M.B. ka pasur dëshirë të martohej me Burim Ramadanin dhe ka dëshiruar që ta ndajë atë nga gruaja e vet. Në një rast, ajo i kishte thënë Burimit: “më marto se përndryshe do të kesh telashe”. Për më tepër, në gjykim M.B. kishte pranuar se kishte pasur telashe me Burimin.

Ankesa e avokates Vahide Braha pohon se M.B. është munduar ta detyrojë Burimin që të martohet me të, por nuk ia kishte dalë mbanë për shkak të faktit se Burimi ishte burrë i martuar duke shtuar se ishte “goxha logjike” që një e dashur me konflikt interesi do të mendohej në çdo moment të hakmerrej për faktin që nuk ishte bërë gruaja e tij. Në deklaratat e saj (shqyrtimi më 27 maj 2004) M.B. ka sqaruar që kishte pasur marrëdhënie me Burimin por pas ca kohe kishin pasur problem ngase ajo kishte dëshirë të punonte në Drenas, ndërsa Burimi nuk pranonte një gjë të tillë. Ajo kishte provuar të ndahej prej tij, mirëpo ai e kishte kërcënuar duke i thënë se do ta vriste dhe i kishte rënë flakaresh. Marrëdhënia e tyre kishte marrë fund.

Më vonë, M.B. nuk kishte marrë vesh se Burimi ishte ndarë prej gruas. Ajo nuk ishte shkuar vullnetarisht në polici për të dhënë deklaratën për Burimin por ishte thirrur nga policia në nëntor 2002. Pas deklaratave të saj para Gjyqtarit hetues më 6 nëntor 2002, ajo ishte kërcënuar nga Arsim Ramadani me qëllim që ajo ta ndryshonte dëshminë e saj. Në atë kohë Burim Ramadani veç ishte në paraburgim.

Dy aktgjykimet e para nuk morën parasysh këtë pohim të mbrojtjes në bazë të një arsyetimi të ngjashëm: “së pari nuk ka shpjegim se çfarë nënkuptohej me ‘telashe’, së

dyti Sami Ferizi nuk është në gjendje të mbajë mend në cilin vit ajo kishte thënë këtë, ose së paku në cilin muaj, javë apo ditë” (aktgjykimi i shkallës së dytë, faqe 25).

Kjo gjykatë pajtohet me vlerësimin e dy gjykatave të para, sepse shprehja “telashe” duket të jetë shumë përgjithësuese që të nënkuptojë shantazh para gjykatës kur bëhet fjalë për akuzën e vrasjes.

Kësaj mund t’i shtohet 1) koha në mes të përfundimit të marrëdhënies së tyre (janar 2002) dhe deklaratave të saj para policisë (nëntor 2002), 2) fakti se ajo nuk kishte shkuar vullnetarisht në polici por ishte ftuar atje dhe 3) rrethanat që asokohe Burimi tashmë ishte shkurorëzuar dhe ishte në paraburgim që nuk përbënte ndonjë dyshim për hakmarrje ndaj tij nga ana e M.B. Në atë kohë, ajo nuk çante fare kokën për Burimin bile as që donte ta dinte nëse ai ishte ende i martuar apo jo.

Deri në atë kohë, marrëdhënia e tyre kishte marrë fund bile bukur gjatë kohë përpara. Ajo nuk ishte shkuar vullnetarisht në polici me qëllim që ta shantazhojë Burimin dhe të hakmerret ndaj tij. Në të kundërtën, ajo ishte ftuar nga hetuesit dhe kishte thënë atë që e dinte, lidhur me atë çfarë i kishte thënë Burimi dhe pa u munduar t’i ekzagjeronte hollësitë që nuk i kishte perceptuar vetë. Përkundër kërcënimeve të pranuar pas dhënies së deklaratave të veta, ajo ka qëndruar prapa dëshmisë së saj. Në kohën e këtyre kërcënimeve, Arsim Ramadani ishte ende i lirë, në fakt ai u arrestua më 31 dhjetor 2002. Të gjitha këto elemente përjashtojnë çfarëdo dëshire të saj (M.B.) për hakmarrje.

-Kjo gjykatë konsideron si të pabazë pretendimin e ankesave që kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë e dëshmisë së M.B. për demonstrimin e besimit se Burim Ramadani po fliste të vërtetën lidhur me vrasjen. M.B. ka përmendur se kishte folur me Burimin për vrasjen menjëherë pas saj në telefon, dhe se e kishte pyetur nëse ai ishte vrasësi, pas së cilës ai menjëherë kishte ndërprerë telefonatën, e kishte thirrur përsëri nga një telefon tjetër duke e fshehur numrin dhe e kishte qortuar për mungesë maturie (“a je normale? Si mund të thuash diçka të tillë përmes telefonit”).

Në atë rast Burimi ishte “nervoz dhe agresiv”. Së dyti, ai i kishte treguar asaj detaje të ndryshme si: “ne do t’i vrasim të gjithë spiunët”, duke shtuar se Hamzë Hajra ishte spiun gjatë luftës dhe “Hamzës nuk do t’i shkonte gjatë”. Pak kohë pas vrasjes, Burimi i kishte thënë se kishte vrarë familjen Hajra së bashku me dikën tjetër (“Do të vras siç kemi vrarë Hamzën”).

Ai i kishte shpjeguar se nuk kishte mundur ta vriste vetëm Hamzën sepse ky ishte në veturë së bashku me familje, dhe se të mbijetuarit do të mund t’i identifikonin kryerësit. Duhet të merret parasysh, se këtë mirëbesim Burim Ramadani e ka pasur me M.B. gjatë marrëdhënies së tyre, që d.m.th. gjatë muajit janar 2002. Në atë kohë Blerim Kiqina ende nuk kishte dhënë deklaratat e tij lidhur me vrasjen dhe numrin e kryerësve (4 korrik 2002).

Kështu, vetëm ai njeri që ka qenë në vendin e krimit ka pasur mundësi t’i referonte M.B. që kryerësit materialë kanë qenë më shumë se në person.

Ky detaj përputhet me deklaratën e Blerim Kiqinës dhe me ekspertizën balistike. Hamëz Hajra kishte punuar në polici me serbë, prandaj ai mund të konsiderohej si "spiun". Pas deklaratave të saj, M.B. është kërcënuar që ta ndryshonte dëshminë e saj.

Tërë kjo na bind mbi sinqeritetin e besimit të Burim Ramadanit ndaj M.B.

-deklaratat e Blerim Kiqinës demonstrojnë përgjegjësinë e Burim Ramadanit për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Ato konfirmohen nga deklaratat koidenciale të M.B. dhe me të gjitha dëshmitë tjera të besueshme, siç është ekspertiza balistike. Demonstrimi i përgjegjësisë së Burim Ramadanit shkon përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në këtë pikë, përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë duhet patjetër të pranohet dhe të mbështetet nga kjo gjykatë.

42. Aktgjykimi i atakuar (faqet 25 – 27) mbështet përgjegjësinë e Arsim Ramadanit dhe të Arben Kiqinës lidhur me këto dëshmi:

-nga dëshmitë e dhëna nga Naim Kiqina, Petrit Ramadan Morina, Fetah Hasani dhe Enver Gashi, rezulton se Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina kanë qenë në oborrin e Kiqinës duke ngrënë shtalba dhe janë nisur së bashku me të tjerët në mes orës 22:00 dhe 22:30;

-kështu, të tre ankuesit kanë qenë së bashku krejt pak para të shtënave, janë nisur së bashku në çastin që do t'u mundësonte të jenë në vendin e krimit para se të arrinte familja Hajra;

-të gjithë këta njerëz kanë dalë nga oborri Kiqina jo më shumë sesa 15 ose 20 minuta para se Hamëz Hajra me familje të ikte nga dasma;

-kështu Burim Ramadani, përgjegjësia e të cilit ishte përcaktuar në bazë të dëshmive të tjera të pavarura (siç janë dëshmitë e Blerim Kiqinës dhe të M.B.), nuk kishte pasur mjaft kohë në dispozicion për të arritur në vendin e pusisë, vetëm nëse kishte shkuar atje me veturë;

-po ashtu pjesëmarrësit tjerë në pusinë e vënë, është dashur që të udhëtojnë së bashku nga vendi i shtalbave deri në vendin e krimit;

-dëshmitari Nazmi Leku konfirmon këtë hipotezë, ngase ai kishte parë kolonën e prej pesë veturash duke kaluar para shtëpisë së tij para të shtënave;

-pasi që shtëpia e Nazmi Lekut është 800/900 metra larg vendit të krimit, distancë kjo që mund të kalohet për pak minuta me veturë, Gjykata e shkallës së dytë përfundon se kjo kolonë është shfrytëzuar nga Burim Ramadani, për të arritur urën e drurit;

-konstrukcioni i njëjtë është miratuar edhe nga Arsim Ramadani dhe nga Arben Kiqina, sepse ata kishin qenë tërë kohën së bashku me Burim Ramadanin dhe me këtë të fundit kanë qenë në kolonën e njëjtë dhe kanë zbritur në vendin e krimit. Me fjalë të tjera, gjykata e shkallës së dytë vërteton se të akuzuarit të shtyrë nga Blerim Kiqina për faktin që Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina kanë udhëtuar së bashku me Burim Ramadanin dhe kanë pasur mundësinë konkrete që të zbresin në vendin e krimit së bashku me të;

-në veçanti lidhur me Arben Kiqinën, gjykata e shkallës së dytë konstaton se është provuar se ai ka qenë pjesë e kësaj pusie, përderisa mungesa e gëzhojave nga arma e tretë nuk zvogëlon besueshmërinë e Blerim Kiqinës dhe përgjegjësinë e ankuesit.

Ankesat atakojnë këtë pikë (ankesa e avokatit Haxhi Millaku, faqe 6, ankesa e avokatit Ibrahim Dobruna, faqe 27, ankesa e avokates Vahide Braha, faqe 15), duke pretenduar:

-gabimin e gjykatës së shkallës së dytë në vlerësimin e kohës së nevojshme nga të pandehurit për ta kaluar distancën (800/900 metra) nga shtëpia e Nazmi Lekut deri në vendin e krimit brenda një kohe që përputhet me pjesëmarrjen e tyre në vënien e pusisë;

-gabimi i bërë nga aktgjykimi i atakuar, i cili nuk merr parasysh se Nazmi Leku nuk i ka parë veturat e të pandehurit në urën e drurit kur kishte arritur aty me gruan dhe me të bijën pak minuta para të shtënave.

Kjo gjykatë i konsideron të dy këto kundërshtime si të pabaza. Në të vërtetë, të tre të pandehurit kanë pasur mundësinë konkrete që të jenë në vendin e krimit me kohë për të marrë pjesë në vënien e pusisë (pritës).

Duke u mbështetur në deklaratën e Nazmi Lekut (shqyrtimi më 23 nëntor 2004, faqe 17), mund të vërehet se ai kishte parë kolonën përpara shtëpisë së tij. Distanca nga shtëpia e tij deri tek ura e drurit (800/900 metra) është e atillë që mund të kalohet për pak minuta. Me qëllim që të jemi më të qartë, duhet të vërehet se një kilometër kalohet:

- për një minutë me veturë që ka shpejtësinë e lëvizjes 60km/h;
- për dy minuta me veturë 30km/h;
- për tre minuta me veturë 20km/h;
- për gjashtë minuta me veturë 10km/h;
- për dhjetë minuta me veturë 6km/h.

Shpejtësia prej 6km/h paraqet shpejtësi që lehtë mund të mbahet edhe duke ecur këmbë. Nazmi Leku ka deklaruar se ka parë kolonën afërsisht 25 ose 30 minuta para se t'i dëgjonte të shtënat (faqe 29).

Ai ka shpjeguar se ka parë kolonën derisa ka qenë duke e hapur portën e oborrit të tij. Pas kësaj, ai ka shkuar te vetura e vet, ka vërejtur se një gomë ishte e shfryrë, është munduar ta frynte me pompë, ka konstatuar se pompimi ishte i padobishëm dhe pastaj ka ndërruar gomën. Të gjitha këto veprime i kanë marrë 15 minuta kohë (faqe 31). Pastaj është kthyer

në shtëpi, ku gruaja ishte duke e pritur për ta bërë gati vajzën që duhej ta dërgonin në spital.

Në shtëpi nuk kishte rrymë dhe për ta bërë gati fëmijën duhej 15 deri në 20 minuta kohë. Gjatë kësaj përgatitjeje të vajzës së tyre, Nazmi Leku dëgjoi të shtënat me armë (faqe 17). Pas kësaj, ai së bashku me gruan dhe fëmijën e tyre u futën në veturë dhe u nisën në drejtim të spitalit të Drenasit, duke vozitur përmes rrugës që shpie tek ura e drurit, ku gjetën veturën të bërë shoshë nga plumbat.

Nazmi Leku ktheu veturën e tij dhe arriti në spital nëpër një rrugë tjetër, rreth shtëpisë së tij. Kur më në fund u kthye nga spitali, ai pa dritat e veturave të policisë.

Duhet të shtohet se Xhevdet Kiqina (shqyrtimi më 3 nëntor 2004, faqe 14) ka sqaruar që në mbrëmjen e 20 gushtit ai ka dalë nga çajtorja e tij dhe ka shkuar për të ngrënë shtalba duke udhëtuar përmes rrugës që kalon nëpër urën e drurit.

Kur është kthyer në çajtores, ai ka udhëtuar përmes rrugës që shpie në Çikatovën e Re. Xhevdet Kiqina ka shpjeguar se rruga nga Drenasi deri në rrugën e urës ka qenë rrugë e asfaltuar, përderisa rruga e Çikatovës ka qenë e paasfaltuar.

Ai ka shtuar se të dy rrugët kanë qenë “me kushte normale” dhe i kujtohet se i janë dashur 10 deri në 15 minuta nga çajtorja deri në vendin ku kanë pjekur shtalba përmes rrugës së urës së drurit dhe afërsisht 15 minuta tjerë gjatë kthimit prapa nëpër rrugën e Çikatovës së Re.

Ashiqare distanca nga çajtorja Xhevdeti deri në vendin e shtalbave është më e gjatë sesa distanca nga shtëpia e Nazmi Lekut deri në urën e drurit.

Mund të përfundohet se njerëzit që ishin përballë shtëpisë së Nazmi Lekut 25 apo 30 minuta para se të fillonin të shtënat nga armët kanë qenë pa asnjë problem në gjendje të arrijnë tek ura e drurit brenda kohës në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në pusinë (pritën), bile edhe po të kishin vozitur krejt ngadalë (20km/h për 3 minuta), shumë ngadalë (10km/h për 6 minuta) ose madje edhe në shpejtësinë e ecjes normale të njeriut (6km/h për 10 minuta).

Dhe ky përfundim është i bazuar pavarësisht çfarë drejtimi kanë pasur ato makina kur Nazmi Leku i kishte parë. Në fakt, ky dëshmitar i ka vërejtur këto vetura vetëm para se ta kontrollonte veturën e vet, sepse pas saj vëmendja e tij ishte e tërhequr nga gjëra të tjera. Ai përshkroi atë rrugën si një rrugë “të ngarkuar”, që shfrytëzohej kur dikush dëshironte të vinte në Baicë (faqe 24).

Pika e dytë e ankesave duket të mos jetë e bazuar thjesht për arsye se 1) Blerim Kiqina ka deklaruar se kryerësit kanë braktisur vendin e krimit në këmbë, 2) Nazmi Lekut i kujtohet se ka dëgjuar të shtënat nga armës derisa ende ishte në shtëpinë e vet derisa gruaja e vet po i ndihmonte vajzës së tyre të vishej dhe pasi kishte dalë nga shtëpia iu deshën rreth dhjetë minuta derisa arriti tek ura e drurit.

Kështu, kryerësit kishin tërë kohën e nevojshme në dispozicion që të largoheshin nga vendi i krimit pasi kishin qëlluar me armë, pa u parë nga Nazmi Leku. Pretendimet e ankesës lidhur me përgjegjësinë e Arsim Ramadanit dhe të Arben Kiqinës, për këtë arsye janë të pabaza. Përgjegjësia e tyre është demonstruar nga vetë deklaratat e Blerim Kiqinës.

Për më tepër, këto deklarata vërtetohen me elemente të tjera tashmë të përmendura nga gjykata e shkallës së dytë: të dy ankuesit kanë qenë së bashku me Burim Ramadanin dhe në fund pas të shtënave ata të dy përsëri u bënë bashkë me Burim Ramadanin në çajtoresh Xheveti. Ekspertiza balistike konfirmon që qitësit kanë qenë më shumë se një.

Sa i përket Arben Kiqinës, arsyetimi i gjykatës së shkallës së dytë duhet të përkrahet sepse është dëshmuar (provuar) se ai ka qenë pjesë e kësaj prite (pusie), përderisa mungesa e gëzhjave të plumbave nga arma e tretë nuk e zvogëlon besueshmërinë e Blerim Kiqinës dhe përgjegjësinë e ankuesit (shih më lart pikën III.37). E tëra kjo shkon përtej çfarëdo dyshimi të bazuar.

#### IV

43. Ankesat pohojnë se ka pasur shkelje të nenit 378 të LPP-së sa i përket dënimit, ngase derisa shkalla e parë ka shqiptuar dënimin prej 30 vjet burgim për katër vepra penale, gjykata e shkallës së dytë ka shqiptuar dënimin e njëjtë por vetëm për dy vepra penale. Për më tepër, rrethanat rënduese të mënyrës tinëzare të vrasjes do të ishin të pasakta.

Këto pika janë të pabaza. Gjukata e shkallës së parë ka zbatuar nenin 71, paragrafin 1 të KPPK-së në përputhje me nenin 48 të KP të RSFJ-së, duke shqiptuar si dënim total vetëm burgimin afatgjatë prej 30 vjetësh. Gjukata e shkallës së dytë, ka zbatuar, në mënyrë më të arsyeshme, nenin 30, paragrafin 3 të LPK-së, i cili përcakton një dënim unik (jo total) prej 10 deri në 40 vjet burgim, po qe se personi ka kryer “disa vrasje me paramendim.”

Arsyetimi i gjykatës së shkallës së dytë duket të jetë i saktë, pasi që në këtë rast nuk mund të zbatohet “burgimi afatgjatë” (të përcaktuar me ligj, KPPK, që ka hyrë në fuqi pas vrasjes dhe e cila dispozitë është më pak e favorshme për të pandehurit) por vetëm dënimi me burgim.

Tashmë për këtë arsye, nenet 71, par. 2, pika 1 e KPPK-së dhe neni 48 i KP të RSFJ-së nuk janë të zbatueshëm. Por ka ende të tjera pika. Neni 30, paragrafi 3 i LPK-së, bashkon shumë vrasje në një vepër të vetme penale, për të cilën parashihet dënim i vetëm (unik) dhe jo dënim total, prandaj ky nen është zbatuar drejt në këtë rast. Kjo dispozitë ligjore është e veçantë (lex specialis) krahasuar me nenin 48 të KP të RSFJ-së dhe me nenin 71 të KPPK-së, prandaj mbizotëron këtë të fundit.

Nga ana e gjykatës së shkallës së dytë nuk kishte kurrfarë “reformatio in pejus” thjesht nga fakti se veprat penale për të cilat janë dënuar të pandehurit nuk ka ndryshuar, por ato janë bashkuar në përputhje me nenin 30, par. 3 të LPK-së dhe kanë dënuar vetëm një herë me një dënim i cili tanimë ishte shqiptuar për vrasjen e parë të rëndë.

Në fakt, Gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar dënimin për të pandehurit në lidhje me akuzën e vrasjes së rënduar nga mënyra tinëzare (neni 30, par. 2, pika 1 e LPK-së), e cila dënohet edhe e vetme (dhe konkretisht ishte dënuar nga ana e shkallës së parë) me 30 vjet burgim. Dënimi për vrasjet e tjera është absorbuar dhe është përfshirë në dënimin e parë, sipas nenit 30, par. 3 të LPK-së.

Aktgjykimi i shkallës së dytë duhet patjetër që të konfirmohet po ashtu edhe për pjesën e dytë. Rrethana rënduese për mënyrën tinëzare të vrasjes, për shkak se viktimat janë futur në pusi (pritë) dhe janë zënë në befasi: kjo paraqet mënyrë tinëzare të sulmit ndaj njerëzve, sipas përkufizimit.

## V

44. Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së dytë vërtetohet në tërësinë e tij. Për këtë arsye, shpenzimet e procedurës gjyqësore të Shkallës së tretë do të barten nga të katër ankuesit.

Në përputhje me nenin 50 të KP të RSFJ-së, koha e kaluar në paraburgim nga secili i pandehur do të llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit.

Përkitazi me paraburgimin e secilit të pandehur, vendoset me një aktvendim të ndarë në përputhje me nenet 353 dhe 387 të LPP.

**Sot më datën shtator 2009,  
API.-KZI Nr. 4/2009**

Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë të autorizuar,

Kryetar i kolegjit  
Emilio Gatti

Procesmbajtësi ndërkombëtar  
Andrea Chmieliński Bigazzi

Gjyqtari ndërkombëtar  
Norbert Koster

Gjyqtari ndërkombëtar  
Guy Van Craen

Gjyqtari kosovar  
Miftar Jasiqi

Gjyqtari kosovar  
Feizullah Hasani

**Këshillë ligjore**

Nuk ka mundësi të paraqitet ankesa kundër këtij Aktgjykimi, por vetëm kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila paraqitet në gjykatën që ka sjellë vendimin në shkallën e parë, brenda 3 muajsh nga dorëzimi i këtij vendimi (nenet 451 – 460, 551 të KPPPK-së).